



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



QENDRA E SHËRBIMEVE
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



Save the Children



MONITORIMI I GJYKATES TË SHKALLËS SË PARË TË RRETHIT LUSHNJE

RAPORT

MARS 2019

Autorë: Av. Blerina Shkurti, PhD, eksperte ligjore

Redaktoi: Isijda Sinjari, PhD.

Kjo raport u prodhuan nga Instituti i Politikave të Qendrueshme në kuadër të projektit "Monitorimi i funksionimit të Gjykatës së Shkalës së Parë të Rrethit Lushnjë" si pjesë e skemës së granteve të projektit "Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Institutit të Politikave të Qendrueshme dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I PROJEKTT	2
2. AKTIVITETET	3
3. METODOLOGJIA	4
4. PUNË KËRKIMORE – KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	5
5. RASTET E STUDIMIT	9
6. TË DHËNA STATISTIKORE	10
7. REZULTATET E MONITORIMIT	21
8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	28
9. REKOMANDIME	29
10. ANEKS 1	30

GJRGJL	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje
Rregullore	Rregullore e GJRGJL miratuar më 19.12.2013
Rregullore	Për përdorimin e pajisjeve elektronike datë 22.03.2017
PT	Programi i Transparencës
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
ANX	Aneks
PE	Procedure efektive
RSH	Republika e Shqipërisë

1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Shqipëria gjatë gjithë këtyre viteve të pluralizmit politik (afro 29 vite demokraci) ka patur për qëllim kryesor forcimin e shtetit ligjor dhe së drejtës. Me synimin për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit. Si rrjedhojë një sistem gjyqësor profesional, efikas dhe i pavarur ka qënë gjithmonë një domosdoshmëri për themelet e një shoqërie demokratike. Atë çka vëndi ynë ka synuar që prej fillim viteve '90.

Siç dihet sistemi gjyqësor shqiptar ka vuajtur që prej fillimit kriza të mëdha të pavarësisë, paanësisë, profesionalizmit, efikasitetit dhe cilësisë në dhënien e drejtësisë. Për këtë arsye projekti jonë është fokusuar si një program monitorimi të problemeve kryesore që hasin institucionet e drejtësisë, gjykatat, dhe në rastin konkret Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje (GJRRGJL). Kjo gjykatë që shtrin juridiksionin e saj në të gjithë rrethin e Lushnjes trajton proçese gjyqësore në fushën e së drejtës Penale dhe atë Civile. Nga ne është zgjedhur pikërisht monitorimi i kësaj gjykate për shkak të largësisë nga kryeqyteti dhe volumit të çështjeve që ajo trajton, për të parë vështirësitë dhe problematikat që hasin kryesisht gjykatat e rretheve me qëllim evedentimin e tyre dhe nxjerrjen e rekomandimeve të ndryshme në funksion të përmirësimit të punës së këtyre institucioneve.

Objektivi kryesor i projektit: Të vlerësojë cilësinë e shërbimeve juridike dhe gjyqësore të ofruara nga gjykata civile e shkallës së parë të Lushnjës.

Projekti synon të adresojë çështjet kryesore që ndikojnë në cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor shqiptar, por me një fokus të veçantë në gjykatën e rretheve të zonave të largëta të cilat mund të përballen me problematika të veçanta. Projekti ka 3 objektiva specifike:

OS1. Vlerësimin e perceptimit të qytetarëve dhe bizneseve në lidhje me cilësinë e shërbimeve gjyqësore dhe komunikimeve gjyqësore;

OS2. Intervistimi i zyrtarëve të gjykatës civile për të identifikuar sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë punës së tyre të përditshme.

OS3. Analiza e treguesve për ecurinë e çështjeve civile të nxjerra nga gjykata e shkallës së parë në Lushnjë;

Ky studim synon të monitorojë dhe të evedentojë problematikat kryesore të kësaj gjykate parë në disa këndvështrime siç janë:

- Përditshmëria e funksionimit të institucionit;
- Korniza ligjore e institucionit, rregulloret e brëndshme të saj;
- Problematikat dhe vështirësitë për shkak të infrastrukturës;
- Problematikat dhe vështirësitë në dhënien e drejtësisë për shkak të organigramës së institucionit;
- Vonesat në dhënien e vendimeve, shkaqet kryesore;
- Problematikat në zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Duke qënë se cilësia dhe efikasiteti i gjyqësorit janë dy aspekte të lidhura ngushtë me njëra tjetrën në të gjithë aktivitetin tonë të monitorimit kemi analizuar me rigorozitet cilësinë e shërbimeve gjyqësore dhe komunikimin ndërmjet palëve (GJRRGJL dhe qytetarëve, biznesit apo çdo lloj pale në proceset gjyqësore pjesëmarrëse). Përvec monitorimit në terren, kemi analizuar çështje konkrete të natyrës civile të zgjedhura me short nga gjykata për periudhën 2015-2017, kemi intervistuar rreth 10 punonjës të institucionit në funksione të ndryshme ketu perfshire dhe 3 avokate, si dhe kemi

shperndare rreth 150 anketa te kenaqesise se perdoruesve te gjykates, nje pjese e te cileve duke qene njekohesisht palë në proceset gjyqësore të zhvilluara pranë kësaj gjykate.

Nga analizimi i çështjeve konkrete, intervistat me punonjësit e GJRRGJL por dhe intervistimi në institucion i palëve në proçese të ndryshme gjyqësore pranë kësaj gjykate kemi evidentuar problematika të ndryshme të cilat në rast se do të vihen në fokus të vet institucionit apo institucioneve të tjera përgjegjëse do të përmirësonin dukshëm cilësinë e funksionimit të tij apo të dhënies së vendimarrjeve gjyqësore.

2. AKTIVITETET

Ky projekt u përqëndrua në monitorimin e funksionimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Gjatë projektit u kryen aktivitete specifike, si vijojnë:

Vizita në institucionin e GJRRGJL, takimi me kryetaren gjykatës. Prezantimi i projektit, qëllimit dhe plan shtrirja e tij në fazat përkatëse. Gjatë këtij takimi i parashtruar Kryetares kërkesën tonë për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimin për të gjithë kohëzgjatjen e projektit. Marrëveshje e cila mbetet ende e pa nënshkruar nga drejtuesi gjykatës por e cila nuk na pengoi në mbarvajtjen dhe të gjitha etapet e monitorimit.

Më pas proceduam me **hulumtimin e kuadrit ligjor të brendshëm** të institucionit ku na u vu në dispozicion aktet si vijojnë: Rregullore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, miratuar datë 19.12.2013; Rregullore për përdorimin e pajisjeve elektronike e rifreskuar, datë 22.03.2017; Programi i Transparencës. Ky studim mbi kuadrin ligjor dhe institucional të GJRRGJL na ndihmoi për të evidentuar disa problematika specifike që rrjedhin pikërisht nga mospërditësimi i këtyre akteve nënligjore.

Gjatë procesit të monitorimit kemi vizituar institucionin për të parë më konkretisht **problematikat infrastrukturore** të cilat ndikojnë negativisht në mbarëvajtjen e punës së përditshme të institucionit. Siç mund të jenë numri i vogël i sallave, kryesisht ato të pajisura me element të sigurisë për proceset penale apo ambienteve për publikun.

U zhvilluan **takime me punonjës** të ndryshëm të institucionit (Kryetar, gjyqëtarë, kancelar, sekretarë, IT, etj) me qëllim intervistimin e tyre në funksion të evidentimit të problematikave gjatë procesit të punës së tyre. Takimi dhe intervistimi i tyre u krye në ambientet e institucionit pa me të voglin hezitim nga ana e tyre duke evidentuar qartazi mangësitë dhe përmirësimet që kërkohen për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të punës në këtë institucion.

Aktiviteti i radhës gjatë procesit të monitorimit, ishte **plotësimi i pyetësorëve të qytetarëve** të ndryshëm palë në proceset gjyqësore të zhvilluara në gjykatë në rolin e palës paditëse apo të paditur si qytetar, avokatë apo biznesmen. Pyetësi ishte gjithpërfshirës dhe u mundua të prekte të gjitha elementet e një procesi gjyqësor. Plotësimi i pyetësorit shpesh hasi vështirësi në bindjen e palës se do të ruhej anonimiteti dhe konfencialiteti i tij. Palët shpreheshin verbalisht mosbesues në përmirësimin e elementëve të proceseve gjyqësore të zhvilluara pranë kësaj gjyakate.

Më tej u procedua nga ana e IT dhe koordinatorit për informacion të institucionit me **përzgjedhjen e 30 çështjeve civile** të zhvilluara nga kjo gjykatë gjatë periudhës 2016-2017. Ky dokumentacion u dorëzua në mënyrë shkresore (hard copy) dhe elektronike specialistit ligjor të projektit.

Pas vizitave, takimeve dhe korrespondencës së mësipërme u kryen **desk research** për kuadrin ligjor dhe institucional si dhe u kryen analizat përkatëse për intervistat, pyetësorët dhe çështjet civile të marra në shqyrtim.

3. METODOLOGJIA:

Si vijonë po ilustruam metodologjinë që ndoqëm në zbatimin e këtij projekti:

1. **Vizita në instucion, takimi punonjësit e institucionit.** Fillimisht u takuam me Kryetaren e Gjykatës. E cila na evidentoj problematikat kryesore që ajo has në drejtimin e institucionit si dhe përpjekjet e saj dhe jo vetëm për të plotësuar mangësit në funksionimin e punës së përditëshme. Gjatë këtij takimi na u bë prezantimi me IT dhe Koordinatorin e Informacionit në mënyrë që të programonim të gjitha etapat e projektit që kishin të bënin me vizitat dhe takimet në institucion.
2. **Inspektimi infrastrukturor** dhe vizita në të gjitha mjediset e institucionit për të parë nga afër problematikat që lidheshin me këtë pjesë, ku vum re mungesën e sallës së pritjes së qytetarëve, numrin e pakët të sallave të gjyqit, sidomos ato të pajisura me element sigurie, zyrat e gjyqetareve të cilët për shkak të hapsirës së vogël nuk mundësonin vëndin e sekretarit, mungesën e dhomës së një serveri të gjykatës si dhe ambientet publike të amortizuara.
3. **Intervista me stafin e GJRRGJL.** Konkretisht me Kryetaren e gjykatës, dy gjyqetarë të zgjedhur në mënyrë rastësore, kancelarin, kryesekretaren, sekretarë, IT dhe Koordinatorin e informacionit të institucionit si dhe intervistimi i disa avokatëve të cilët trajtonin çështje në këtë gjykatë. Gjatë të gjitha intervistave evidentuam bashkëpunimin dhe nevojën që kishin për tu dëgjuar për të gjitha vështirësitë që ato hasnin gjatë përditshëmërisë së tyre në punë.
4. **Plotësimi i pyetësorëve nga palët pjesëmarrëse** në proceset gjyqësore. Plotësimi i pyetësorëve është bërë si nga pala e paditur dhe ajo paditëe, në rolin e qytetarëve apo përfaqësuesve të bizneseve. Gjatë kësaj faze kemi hasur vështirësi në bashkëpunimin e qytetarëve për të plotësuar pyetësorët për shkak të pakënaqësive që ato shfaqnin kryesisht për të gjithë sistemin e drejtësisë dhe vecanërisht për zvarritjen e proceseve gjyqësore.
5. **Analizimi i çështjeve gjyqësore civile** të përzgjedhura me short nga gjykata. Janë trajtuar dhe analizuar rreth 30 çështje civile sipas indikatorëve të paracaktuar në funksion të projektit. Ku do të veconim, natyrën e çështjeve, kohëzgjatjen e saj, arsyet e shtyrjeve të proceseve, numrin e seancave jo efektive gjatë një procesi gjyqësor, etj.
6. **Analizimi i Intervistave dhe Pyetësorevë** me qëllim kryesor evidentimin e vështirësive kryesore gjatë funksionimit të institucionit si dhe cross-check të problematikave të evidentuara si nga pala që ofron shërbimin dhe nga pala që e merr atë.
7. **Përpunimi i të dhënave statistikore** që rezultuan nga plotësimi i anketave të kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës (pyetësorëve). Këto të dhëna u përpunuan në formë tabelash dhe grafikësh.

4. PUNË KËRKIMORE – KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

4.1 Korniza ligjore institucionale e Gjykatës së Rrethit të Lushnjes.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje e bazon punën e saj në pak akte nënligjore të brendshme të cilat kanë nevojë të thellë për përmirësim, përditësim, dhe përshtatshmëri me aktet e tjera ligjore. Kështu kjo gjykatë e mbështet funksionin e saj në Rregulloren e brendshme të institucionit e cila është miratuar në datë 19.12.2013.¹ Kjo rregullore përcakton organikën dhe funksionet përkatëse të cdo punonjësi të këtij institucioni si më poshtë vijon:

Nr.	Funksioni	Numri Organik	Numri Faktik	Meshkuj	Femra	Kategorizimi i pagës
1.	Kryetar	1	1		1	
2.	Gjyqtarë	4	3		3	
3.	Kancelar	1	1	1		
4.	Kryesekretar	1	1		1	III-b
5.	Sekretar gjyqësor	5	5		5	IV-a
6.	Nëpunës gjyqësor	1	1	1		
7.	Kryetar i Degës së Buxhetit	1	1		1	III-b
8.	Specialist IT & marrëdhënie me publikun dhe mediat	1	1		1	IV-a
9.	Arkivist	1	1		1	IV-b
10.	Sanitar	1	1		1	
11.	Shofer dhe mirëmbajtës	1	1	1		
12.	Punonjës sigurie	1	1	1		
	TOTAL	19	18	4	14	

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje përfshin në kompetencën e saj tokësore rrethin e Lushnjes², me qendër të ushtrimit të veprimtarisë së saj në qytetin e Lushnjes. Kjo gjykatë ka në organikën e saj 5 gjyqtarë³ nga të cilët vetëm katër prej tyre ushtrojnë detyrën pranë kësaj gjykate. Për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve kjo gjykatë nuk është e organizuar në dhoma. Në bazë të Rregullores së brendshme të Gjykatës, Kryetari i Gjykatës një herë në dy vjet vendos me urdhër shpërndarjen e përgjithëshme të gjyqtarëve në dhoma e seksione si dhe në trupa gjykues. Kryetari mund të urdhërojë dhe ndryshimin e pjesshëm të kësaj shpërndarje përpara këtij afati në raste të jashtëzakonshme dhe përjashtimore. Aktualisht gjykata drejtohet nga gjyqtarja Esmeralda Çeka emëruar me vendimin nr. 109, datë 23.07.2014 të KLD-së.

Kjo rregullore gjen zbatim në të gjitha marrëdhëniet administrative dhe administrative-procedurale, ndërmjet degëve të sektorëve të administratës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, si dhe ndërmjet këtyre të fundit me gjyqtarët, publikun dhe median. Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë funksionimin e veprimtarisë së gjykatës në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe akteve

¹ Kjo rregullore bazohet në Ligj tashmë i shfuqizuar. Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Aktualisht është në fuqi Ligji 98/2016, Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

² Shih Dekretin e Presidentit të RSH nr. 6201, datë 08.06.2009 “Për caktimin e kompetencave tokësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë të secilës prej tyre”

³ Shih Dekretin e Presidentit të RSH nr.8718, datë 16.11.2012

nënligjore në fushën e sistemit gjyqësor, për të unifikuar, standartizuar dhe harmonizuar veprimtarinë administrative të kësaj gjykate. Sipas kësaj rregullore Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje ka kompetencë lëndore shyrtime të mosmarrëveshjeve: Civile; Tregtare; Familjare; Çështje Penale.

Në bazë të rregullores çështjet gjyqësore civile pranës kësaj gjykate ndahen me short për gjykim në mënyrë të barabartë ndërmjet gjyqëtarëve të dhomës civile, sipas natyrës së çështjeve. Ndërsa Urdhërat e Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe kërkesat gjatë fazës së hetimeve paraprake shqyrtohen nga gjyqtari i gatshëm sipas grafikut të gadishmërisë të përcaktuar nga kryetari i gjykatës (rendin alfabetik me bazë mbiemrin⁴). Për shqyrtimin e të gjitha kërkesave të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, krijohet një regjistër i veçantë për këtë qëllim në kryesekretari.

Për çështjet civile, për të cilat gjykata ka disponuar më parë me vendim jo përfundimtar të pushimit të gjykimit të çështjes ose të kthimit të akteve, shorti konsiderohet i realizuar një herë dhe, për këtë arsye, përjashtohen nga një short i ri dhe i kalojnë automatikisht të njëjtit gjyqtar. Në opinionin tonë kjo procedurë i shërben jo vetëm ekonomisë gjyqësore por edhe palës që ka një interes të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes e cila është e interesuar mos të vonohej sërish me afatin kohor të hedhjes së shortit. Megjithatë në çdo rast gjyqtari i çështjes apo pala e interesuar mund të kërkojë dorëheqjen e kyetarit të seancës për shkaqe të përligjura. Kjo procedurë regjistrohet në një regjistër të veçantë në kryesekretari i cili është në përgjegjësi të kryesekretares dhe në mungesë të saj të kancelarit të gjykatës.

Për çështje të cilat vendimi i dhënë është cënuar nga një gjykatë me e lartë dhe vijnë sërish për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, kryetari i Gjykatës përjashton nga shorti gjyqtarin që ka dhënë vendimin e cënuar. Ky përjashtim është i motivuar dhe përligjur, në mënyrë të tillë që t'i garantoj palës paanësi dhe jo paragjykim të çështjes objekt shqyrtimi.

Për të qënë sa më të informuar dhe koherent me rastet e gjykimeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, kryetari i kësaj gjykate organizon në mënyrë periodike me urdhër të veçantë diskutime për çështje të natyrës juridike, bazuar në përgjithësimin e përvojës së gjykimit, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave më të larta, vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, aktet e kontrollit dhe inspektimit të ushtruara nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, dosjet e dorëzuara jashtë afatit në kryesekretari, si dhe çështjet e zgjatura në gjykim. Këto diskutime asistohen nga Kancelari i gjykatës.

Në rregullore është parashikuar mënyra dhe realizimi i planifikimeve të seancave gjyqësore, kështu çdo gjyqëtar në koordinim me gjyqtarët e tjerë duhet të planifikojë seancat gjyqësore në mënyrë të tillë që të maksimizohet shfrytëzimi i sallave të gjykimit të cilat pa përjashtim janë pajisur me sistem audio, në mënyrë që të evitohet sa më shumë të mundet zhvillimi i seancave gjyqësore në zyrat e gjyqëtarëve. Duke evituar kështu çdo anomali apo pretendim nga palët subjekte të mosmarrëveshjeve. Për të përmbushur këtë qëllim gjyqtarët duhet të plotësojnë disa kritere:

1. Caktimi i qartë dhe i saktë i datës dhe orës së zhvillimit të seancës së gjykimit;
2. Njoftimi në kohë i palëve, duke përdorur mjetet e duhura dhe të njohura nga ligji;
3. Zhvillimi i seancave gjyqësore në orarin e parashikuar.

Për procedurat e mësipërme sipas kësaj rregulloreje është përgjegjës gjyqtari dhe sekretaria përkatëse.

⁴ Neni 18 & 3/c të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"

Në rast mungese të arsyetuar të gjyqtarit në rregullore është parashikuar dhe plotësimi dhe dorëzimi pararak i fletës së lejes i cili duhet të miratohet nga Kryetari i Gjykatës (modeli bashkëlidhur këtij raporti⁵).

Në bazë të rregullores së brendshme gjyqtarët duhet të dorëzojnë në Kryesekretari dosjet civile brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, ndërsa dosjet penale brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Kur dita e fundit e dorëzimit të dosjeve bie ditë pushimi, afati i dorëzimit mbaron në ditën e punës që vjen pas ditës së pushimit. Kjo procedurë i shërben palës për t'u njohur më saktësisht me vendimin e gjykatës në mënyrë që të përpilojë ankimin e saj (nëse ka) në bazë të këtij vendimi apo të kërkojë ekzekutimin e tij, kur vendimi ka marrë formë të prerë.

Po në këtë rregullore është trajtuar funksionimi i shortimit elektronik të zgjedhjes së gjyqtarit. Në këtë gjykatë është në funksionim sistemi i integruar i menaxhimit të çështjeve civile dhe penale (ICMIS), nëpërmjet të cilit shorti, pra ndarja rastësore e çështjeve për gjykim, nuk është i menjëhershëm dhe i veçantë për çdo çështje, por realizohet pas regjistrimit tërësor të çështjeve të ardhura për gjykim, nëpërmjet dhënies së komandës përkatëse “Shortimi”, nga kryetari i gjykatës. Në këtë fazë duhet të theksojmë se kjo procedurë garanton dy elementë kryesorë që duhet të përmbajë një proces i rregullt gjyqësor që janë:

- Garantimi i transparencës;
- Garantimi i paanësisë.

Procedura e shortimit elektronik është një premisë shumë e mirë për respektimin e dy elementëve të mësipërm. Kështu sipas rregullores së kësaj Gjykate shorti elektronik për çështjet civile, familjare, tregtare dhe penale do të realizohet dy herë në javë, ditën e Hënë dhe të Enjte ora 14.00 si më poshtë:

- Çështjet e depozituara nga dita e Hënë, deri në ditën e Mërkurë, i nënshtrohen shortit elektronik të ditës së Enjte, ora 14.00.
- Çështjet e depozituara nga dita e Enjte, deri në ditën e Premte, i nënshtrohen shortit elektronik të ditës së Hënë ora 14.00.

Ndërsa për çështjet civile dhe penale që sipas Kodit të Procedurës Civile dhe Penale përcaktohet një afat i shkurtër gjykimi, nuk do të pritët datat e shorteve por do të hidhen në short menjëherë. Lloji i çështjeve që do të përfshihen në këtë kategori janë përcaktuar në mënyrë taksative në këtë rregullore. Gjithashtu në rregullore janë përcaktuar në mënyrë shteruese të gjitha çështjet civile dhe penale që do të përfshihen nga shorti. *Kjo në opinionin tonë është mjaft transparente dhe lejon verifikimin (aksesin) në çdo kohë të palës së interesuar.*

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në aktet nënligjore të gjykatës është dhe parashikimi i solemnitetit të zhvillimit të seancave gjyqësore dhe respektimi i tij jo vetëm nga punonjësit e gjykatës por dhe nga palët pjesëmarrëse në proces. Theksojmë se rregullimi i këtij momenti në mënyrë taksative është i rëndësishëm për respektimin e vetë procesit gjyqësor dhe theksimin e rëndësisë që ka ai për realizimin e të drejtave të pretenduara gjatë zgjidhjes së një mosmarrëveshje civile apo çështjeje penale.

Rregullorja parashikon në mënyrë të detajuar punën dhe shërbimet që kryen Kryesekretari gjykatës i cili do të merret ekskluzivisht me procesin e administrimit të dosjeve civile apo penale, që në momentin e depozitimit të kërkesave civile apo kërkesë padive dhe çështjeve penale të ardhura

⁵ Shih anekset bashkëlidhur këtij Raporti

nga prokuroria. Në opinionin tonë të gjitha aktet të cilat administrohen nga Kryesekretari për efekt aksesi sa më të shpejtë e korrekt duhet të digjitalizohen në servera përkatës nën administrimin e po të njëjtës gjykatë.

Në rregullore janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe taksative dhe detyrat e sekretarit të seancës/gjyqtarit, nëpunësit gjyqësor, IT-së, njësisë së marrdhënieve me publikun dhe median, sheshe të financave, dhe punonjësit të shërbimeve ndihmëse.

Gjatë shqyrtimit të akteve nënligjore mbi bazën e të cilave funksionon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, dhe kryesisht të rregullores bazë të kësaj gjykate vëmë re një mospërputhje të lehtë ndërmjet organigramës aktuale të gjykatës dhe parashikimeve të bëra në këtë rregullore. Kështu përshëmbull vlen të përmendet mos parashikimi i detyrave funksionale të Kancelarit të Gjykatës në rregulloren e miratuar në vitin 2013. Ashtu siç dhe shprehet vetë dhe rregullorja, për shkak se në periudhën e miratimit të saj nuk ishte parashikuar në organik pozicioni i Kryesekretarit, shpesh herë në këtë akt do të gjejmë të konfunduar detyrat dhe veprimtarin e Kancelarit me atë të Kryesekretarit të gjykatës.

Për sa më sipër sygjerojmë rregullimin e këtij momenti me anë të një amendimi, i cili do të reflektojë më saktësisht organikën aktuale të vet Gjykatës.

Një akt tjetër nënligjor në funksion të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje është dhe **Rregullorja për përdorimin e pajisjeve elektronike** e rifreskuar, datë 22.03.2017. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë procedurat organizative dhe teknike të masave për mbrojtjen e mjeteve të teknologjisë së informacionit, ruajtjes dhe administrimit të tyre nga ana e përdoruesit të autorizuar në gjykatë. Kjo rregullore përcakton në mënyrë të qartë mënyrën e funksionimit të pajisjeve elektronike në funksion të kësaj gjykate, mënyrën e autorizimit dhe të veprimit të punonjësit të autorizuar për t'i përdorur këto pajisje si dhe kufizimet përkatëse në aksesin e informacionit që gjenerohet nga pajisjet teknologjike.

Na rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje nuk disponon rregulla të posaçme në Rregulloren e saj të brëndshme lidhur me përdorimin e Sistemit Audio. Çdo seancë që regjistrohet me mjete të regjistrimit audio në këtë Gjykatë zbatohet Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr.353, datë 03.09.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”, si dhe Urdhërit të Ministrisë nr 4895/5 viti 2016 “Për miratimin e Rregullores mbi metodiken dhe tipologjinë e menaxhimit të shërbimit arkivor gjyqësor”. Regjistrimet kryhen lokalisht në kompjuterat të cilët kryejnë regjistrimin dhe më pas nëpërmjet konfigurimit të programit të gjitha seancat arshivohen në një folder të përcaktuar në server.

Gjejmë me vend amendimin e kësaj rregulloreje përsa i përket:

- Përcaktimit të llojit të informacionit që do të qarkullojë/ ruhet në pajisjet teknologjike;
- Mënyrën dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së informacionit i cili regjistrohet nga këto pajisje;
- Procedurën e arkivimit të seancave gjyqësore të regjistruara me sistem audio, dhe aksesimin e këtyre materialeve në bazë të kërkesave të palëve të legjitimuara;
- Shpërndarjen e saktë të pajisjeve teknologjike në ambientet e gjykatës.

Një akt tjetër që zbatohet në këtë institucion është dhe **Programi i Transparencës** i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje i cili bazohet në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Me anë të këtij programi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje synon të ndërtojë dhe të rrisë në mënyrë konkrete transparencën dhe aksesin në informacionin e kërkuar nga palët e interesuara. Megjithatë vihet re ekzistenca e një programi transparence në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës⁶, në këtë

⁶ <http://ëëë.gjykata.gov.al/rrethi-lushnje/gjykata-e-rrethi-lushnje/programi-i-transparences/programi-i-transparences/>

faqe mungon një rregullore e detajuar për funksionimin hap pas hapi të programit të transparencës, i cili do të rregullonte në mënyrë më të detajuar aksesin në informacionin publik të Gjykatës.

5. RASTET E STUDIMIT

Gjatë procesit të monitorimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje kemi analizuar rreth 30 çështje civile të shqyrtuara nga kjo gjykatë në periudhën 2016-2017.

Të gjitha çështjet e analizuara nga ne janë përzgjedhur me short nga Koordinatori për informacion i kësaj gjykate. Çështjet e përzgjedhura janë kualifikuar nga ana jonë në bazë të disa indikatorëve të paracaktuar të cilët i referohen vetëm pjesës procedurale të zhvillimit të seancave gjyqësore. Ky process përputhet plotësisht me qëllimin e këtij projekti i cili ka si objekt monitorimin e punës së GJRGJL.

Nga çështjet e përzgjedhura kemi konstatuar se kryesisht **palë** në proceset civile pranë kësaj gjykate janë individët, persona fizik të cilët i referohen kësaj gjykate për zgjidhjen e mosëmarrëveshjeve civile kryesisht të **natyrës pasurore, pronësore**. Kështu rezultoi se nga 31 çështje civile të trajtuara në këtë raport 11 prej tyre kanë patur për konflikt marrëdhëniet familjare, kryesisht çështje që lidhen me zgjidhjen e martesës, lënien në kujdestari të fëmijës së mitur apo detyrimin për ushqim të bashkëshortëve kundrejt njëri tjetrit. Nga këto çështje rezulton se mesatarisht numri maksimal i seancave gjyqësore ka qënë rreth 3 për çështje, nga të cilat në shumicën e rasteve rezultojnë seanca efektive. Kohëzgjatja nga njëra seancë në tjetrën për shkak dhe të natyrës së konfliktit rezulton të jetë mesatarisht 15 ditë pune. Të gjitha çështje gjyqësore të natyrës familjare të përzgjedhura në këtë raport rezultojnë me vendim të formës së prerë.

Nga shqyrtimi i çështjeve të mbetura, vihet re një shumëllojshmëri të çështjeve me natyrë civile, të cilat lidhen kryesisht me çështje pronësie, vërtetim fakti, shkaktim dëmi, pagim detyrimi si dhe me kundërshtime të veprimeve përmbarimore.

Kohëzgjatja e gjyqësorëve të çështjeve gjyqësore shpeshherë cënon të drejtën e palëve për një gjykim të drejtë duke përfshirë edhe të drejtën për gjykim brënda një afati kohor të arsyeshëm. Kështu llogaritja e afatit kohor fillon që nga çasti kur çështja i referohet autoritetit gjyqësor kompetent dhe konsiderohet i përfunduar pas marrjes së një vendimi (të formës së prerë).

Neni 42 pika 2 i Kushtetutës së RSH shprehet se “Kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brënda një afati të arsyeshëm.” Të njëjtin parim e gjejmë të reflektuar dhe në KPrC ku thuhet se gjykata duhet ta gjykojë çështjen brënda një “afati të arsyeshëm.” Po të analizojmë KPrC do të vëmë re që ndryshe nga procedura penale, nuk përcaktohet një afat maksimal kohor ndërmjet seancave. Por është vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë i cili ka orientuar gjykatat lidhur me afatet kohore procedurale për disa lloje çështjes⁷. Vonesat në gjykim qoftë edhe të vogla në kohë, apo duke mos cënuar drejtpërdrejtë ineteresat e palëve pengojnë në mënyrë indirekte efincencën e punës së institucionit i cili nëse do të funksiononte normalisht koha e fituar mund të shërbente për të gjykuar më shumë çështje. Për secilin nga proceset e analizuara u zhvilluan mesatarisht 4.5 seanca gjyqësore ku rreth 45% e tyre ishin totalisht joefektive (jo produktive) dmth nuk ka ndodhur asgjë thelbësore për të zgjidhur mosmarrëveshjen civile objekt gjykimi. Në këto seanca arsyeja kryesore e joproduktivitetit të tyre ishte kryesisht mos marrja ose vonesa në njoftime të palëve. Element ky

⁷ Vendimi i KLD, Nr. 199/3, i datës 15 shtator 2006 “Për kriteret e vlerësimit të veprimtarisë gjyqësore” pika 5 b-e: Afatet e gjykimit në shkallën e parë: 1. Gjykimet në mosmarrëveshje tregtare – maksimumi 6 muaj; 2. Gjykimet në mosmarrëveshjet familjare – maksimumi 4 muaj; Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile me karakter të përgjithshëm-maksimumi 6 muaj.”

totalisht administrativ dhe lehtësisht i kapërcyeshëm nga ky institucion. Gjykata shpesh është hasur me problemin e njoftimit të rregullt të palëve të thirrura në seancë, për shkak të adresave jo të sakta dhe mungesës së aksesit në databazat e adresave në nivel qendror dhe vendor.

Nga sa më sipër vëmë re se *institucioni jo gjithmonë ka përdorur mënyrat më të shpejta të njoftimit, të lejuara me ligj.*

Gjatë analizës së çështjeve civile u konstatua se *një nga shkaqet kryesore të kohëzgjatjes së seancave është dhe mbingarkesa e gjyqëtarëve me procese gjyqësore.* Duke patur fluks dhe volum të madh të çështjeve që kanë në shqyrtim gjyqtarët caktojnë seancat gjyqësore me diferencë kohore të gjatë midis njëra tjetrës. Pavarësisht se u vu re konsultimi paraprak i gjyqëtarëve me palët pjesëmarrëse në proces për vendosjen e një kalendari të seancave pasardhëse u konstatua që ngarkesa e gjyqëtarëve kishte influencën më të madhe në caktimin e datave pasardhëse.

Një element tjetër që vihet re në shtimin e numrit të seancave jo efektive pranë kësaj gjykate është dhe *mungesa e pjesëmarrësve (palëve, ekspertëve, etj) në proceset gjyqësore.* Gjithashtu, kriteret për sanksionimin e pjesëmarrësve që mungojnë në gjykim janë shumë të paqarta. Edhe Kodi i Procedurës Civile nuk përcakton qartë një procedurë që duhet ndjekur nga gjykatat për të përcaktuar shkaqet e mosparaqitjes së pjesëmarrësve në gjykim. Kjo bën që gjyqtarët të hezitojnë për të vendosur sanksione ndaj pjesëmarrësve që mungojnë në gjykim. Edhe ato sanksione që u përdorën në rastet e vëzhguara ishin shumë të buta dhe gjyqtarët nuk dukej se i përdorin plotësisht. Sistemi disiplinor për avokatët nuk duket të ishte plotësisht funksional. Ndërkohë, palët pjesëmarrëse në gjykim nuk janë të detyruara me ligj të njoftojnë gjykatën përpara seancës nëse nuk mund të jenë të pranishëm, duke bërë që pjesëmarrësit e tjerë të paraqiten kot në seancë.

Një arsye tjetër për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore të analizuara kanë qënë dhe *seancat përgatitore shpesh jo efektive (rreth 20% të seancave janë shtyrë për shkaqe të lidhura me provat).* Shpesh herë, provat nuk u paraqitën në momentin më të parë të mundshëm, por u lanë për më vonë.

Gjetjet dhe rekomandimet të nxjerra nga analizimi i indikatorëve të mësipërme do të të parashtrihen në fund të këtij raporti.

6. TË DHËNA STATISTIKORE

ANKETA E KËNAQËSISË SË PËRDORUESVE, GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE.

Nje nga aktivitetet e projektit ishte shpërndarja e anketave të kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës tek qytetarët dhe bizneset. Nga 100 pyetësorë të parashikuar ne shpërndamë 120. Hartimi i pyetësorit u bazua tek metodologjia e Komisionit Europian CEPEJ.

Qëllimi i shpërndarjes së pyetësorëve ishte mbledhja e informacionit cilesor dhe sasior lidhur me matjen e kënaqësisë së ofrimit të shërbimeve nga Gjykata Lushnje për palët pjesëmarrëse në proceset gjyqësore. Pjesa e parë e pyetësorit përmban pyetje lidhur me gjininë, moshën, arsimin, arsyet e vajtjes në gjykatë, lloji i procedurës mbi të cilën bazohej çështja, nëse seancat u zhvilluan në gjuhën amtare dhe nëse u caktua një përkthyes në rastet kur procesi u zhvillua në gjuhë të huaj. Një pyetje e vecantë fokusohet në vlerësimin e besimit në sistemin e drejtësisë.

Pjesa e dytë e pyetësorit u fokusua në rëndësinë që i jep publiku elementëve përbërës të gjithë procesit gjyqësor në përgjithësi duke filluar nga:

a) Kushtet e ambienteve fizike të gjykatës si: mobilimi i sallës së gjykimit, shënimet në ndërtesën e gjykatës, kushtet e pritjes dhe kushtet e aksesit në gjykatë.

b) Elementë të lidhur me procedurën e njoftimeve si: qartësia e fletëthirrjeve dhe njoftimeve, periudha kohore ndërmjet njoftimit dhe seancës gjyqësore.

c) Elementë të lidhur me zhvillimin e procesit gjyqësor si: korrektësia e seancës gjyqësore, qëndrimi dhe sjellja e stafit të gjykatës, niveli i kompetencës së stafit jo-gjyqësor të gjykatës, qëndrimi dhe sjellja e gjyqëtarëve dhe prokurorëve, gjuha e përdorur nga gjyqëtarët dhe prokurorët, koha e lejuar për të parashtuar argumentet në seancë.

d) Elementë të lidhur me dhënien e vendimeve si: afati kohor në dhënien e vendimeve gjyqësore dhe qartësia e vendimeve gjyqësore.

Vëmë re se kryesisht mosha e të anketuarve varjon nga 30 deri në 60 vjeç prej të cilëve pjesa më e madhe ishin të gjinisë mashkullore, 67% meshkuj kundrejt 33% femra. Anketimi i tyre është bërë në ditë të ndryshme pune të Gjykatës dhe pa preferenca përzgjedhjeje. Më shumë se 50% e të anketuarve rezulton me arsim të mesëm dhe vetëm 21% me arsim të lartë (kjo e dhënë mund të shërbejë si referencë për një studim nëse kjo shtresë e shoqërisë i drejtohet më parë ndërmjetësimit sesa gjykatës për zgjidhjen e mosëmarrëveshjeve të ndryshme), pjesa më e madhe e të cilëve rezulton palë e interesuar në një proces gjyqësor të zhvilluar pranë kësaj gjykate (palë paditëse ose të paditur), rreth 44% e të anketuarve. 33% e cështjeve i përkasin procedurës civile dhe 31 % procedurës penale.

Tabela 1. Mosha

Mosha	F	F	M	M
31-50	20	17%	28	23%
18-30	12	10%	28	23%
51-65	5	4%	17	14%
mbi 65	3	3%	7	6%
Total	40	33%	80	67%

Tabela 2. Arsimi

Arsimi	F	F	M	M
8-9 vjecar	7	6%	16	13%
I mesem	23	19%	41	34%
I larte	9	8%	16	13%
E paplotesuar	1	1%	7	6%
Total	40	33%	80	67%


Tabela 3. Procedura

Procedura	F	F	M	M
Civile	25	21%	40	33%
Penale	14	12%	37	31%
e drejta e punes		0%	3	3%
procedura tregetare	1	1%		0%
	40	33%	80	67%

Tabela 4. Arsytet e vajtjes ne gjykate


Arsyet për gjykatë	F	F	M	M
Dëshmitar		0%	7	6%
Palë e procesit gjyqësor	20	17%	44	37%
Për të depozituar një kërkesë padi	2	2%	4	3%
Për të marrë informacion para depozitimit të kërkesë padisë	1	1%		0%
Të marrë informacion mbi ecurinë e dosjes	2	2%	5	4%
Tjetër (p.sh. familjar i njëres prej palëve, i interesuar për informacion, vizitor etj.)	11	9%	13	11%
Vërtetime	4	3%	2	2%
Prapësime		0	1	1%
Te marrë pjesë në seancë dëgjimore/gjyqësore		0	4	3%
Total	40	33%	80	67%

Grafik 1.




Grafiku i mësipërm i referohet nivelit të besimit tek sistemi i drejtësisë në përgjithësi parë kjo në nivel mikro sic është Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Lushnje. Nga anketimi, ku moren pjese 120 persona, rezulton se publiku nuk ka besim të plotë tek garantimi i së drejtës nga institucioni i gjykatave në vlerën mbi 45%.


1. Shënimet në ndërtesën e gjykatës




2. Mobilimi i sallës së gjykimit




3. Kushtet e pritjes




4. Kushtet e aksesit në gjykatë




5. Qartësia e fletë-thirrjeve dhe njoftimeve




6. Qëndrimi dhe sjellja e stafit të gjykatës




7. Korrektësia e seancës gjyqësore




8. Gjuha e përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët




9. Qëndrimi dhe sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve



10. Niveli i kompetencës së stafit jo-gjyqësor të gjykatës




11. Koha e lejuar për të parashtruar argumentet tuaja në seancë




■ Koha e lejuar për të parashtruar argumentet tuaja në seancë

12. Afati kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore




■ Afati kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore

13. Informacioni i dhënë nga shërbimi i informacionit i gjykatës




■ Informacioni i dhënë nga shërbimi i informacionit i gjykatës

14. Qartësia e vendimeve gjyqësore



■ Qartësia e vendimeve gjyqësore

15. Periudha kohore ndërmjet njoftimit dhe seancës gjyqësore





■ Periudha kohore ndërmjet njoftimit dhe seancës gjyqësore

Nga grafiket e mësipërm vihet re se publiku (palët pjesëmarrëse në proceset gjyqësore) konsideron si jo shumë të rëndësishëm kushtet e infrastrukturës së godinës së gjykatës ku përfshihet këtu mobilimi i sallave gjyqësore dhe ato të pritjes por vihet re një ndjeshmëri (mesatarisht e rëndësishme) e tij përse i përket çështjeve të lehtësirave të aksesit në gjykatë, qartësisë së fletëthirrjeve dhe njoftimeve, periudhës kohore ndërmjet njoftimit dhe seancës gjyqësore, korrektësisë së seancave gjyqësore.


Nga pyetësorët e realizuar konstatohet se pikë (e rëndësishme) kryesore e normalitetit dhe përceptimit si të suksesshëm të mbarëvajtjes së një procesi gjyqësorë palët konsiderojnë raportet dhe komunikimin me administratën e gjykatës, gjyqtarët dhe prokurorët, qëndrimin dhe sjelljen e stafit të gjykatës (administrativ dhe gjyqësorë) dhe prokurorëve, nivelin e kompetencës së stafit jo-gjyqësor të gjykatës,

Qytetarët kanë listuar si shumë të rëndësishme: periudhën kohore ndërmjet njoftimit të seancës gjyqësore, korrektësinë e mbarëvajtjes së seancës, gjuha e përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët, kohën e lejuar për të parashtruar argumentet gjatë një seance gjyqësore, koha dhe afati kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore, qartësinë e vendimeve gjyqësore, informacioni i dhënë nga shërbimi i informacionit të gjykatës.


Pjesa e dyte e anketës. Lidhet me nivelin e kënaqësisë së shërbimeve të ofruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje.




3. Kushtet e pritjes




4. Mobilimi i sallës së gjyqimit




5. Periudha kohore ndërmjet njoftimit dhe seancës gjyqësore




6. Qartësia e fletë-thirrjeve dhe njoftimeve




7. Qëndrimi dhe sjellja e stafit të gjykatës



8. Korrektësia e seancës gjyqësore




9. Qëndrimi dhe sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve




■ Qëndrimi dhe sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve

10. Niveli i kompetencës së stafit jo-gjyqësor të gjykatës




■ Niveli i kompetencës së stafit jo-gjyqësor të gjykatës

11. Gjuha e përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët




■ Gjuha e përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët

12. Koha e lejuar për të parashtruar argumentet tuaja në seancë




■ Koha e lejuar për të parashtruar argumentet tuaja në seancë

13. Qartësia e vendimeve gjyqësore




■ Qartësia e vendimeve gjyqësore

14. Afati kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore



■ Afati kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore

15. Informacioni i dhënë nga shërbimi i informacionit i gjykatës



Nga analiza e statistikave të përpunuara nga ana jonë vëmë re se publiku, pjesëmarrës në seancat gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje shprehet se infrastruktura e institucionit (kushtet e aksesit në gjykatë, shënimet në ndërtesën e gjykatës, kushtet e pritjes dhe mobilimi i sallës së gjyqimit) dhe publikimi i njoftimeve publike në ambjentet e gjykatës është mesatarisht jo shumë i kënaqshëm. Këtë element e kemi konstatuar edhe në gjatë vizitës në institucion dhe e kemi specifikuar dhe në këtë raport. Nga vizita jonë rezulton se gjykata nuk ka një ambient komod pritjeje për qytetarët si dhe njoftimet publike afishohen në murin pranë hyrjes së gjykatës.


Nga anketa rezulton se qytetarët janë të kënaqur nga qartësia e fletë thirrjeve (njoftimeve) (68%) por shprehin pakënaqësi për periudhën kohore ndërmjet seancave gjyqësore (59%), gjithashtu ato shprehen **të kënaqur** nga qëndrimi dhe sjellja e stafit të gjykatës (70%), korrektësia e seanceës gjyqësore (58%), informacioni i dhënë nga shërbimi i informacionit të gjykatës (90%). 59% e të anketuarve shprehen jo shumë të kënaqur me periudhën kohore ndërmjet njoftimit dhe seancës gjyqësore kundrejt 33% të cilët shprehen të kënaqur. Ndërkohë lidhur me afatin kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore 47% e të anketuarve nuk janë të kënaqur dhe 43% shprehen të kënaqur.

Pjesa më e madhe e të anketuarve shprehen të kënaqur nga kompetenca e stafit të jo gjyqësor të gjykatës (71%) kundrejt 22% që shprehin pakënaqësi. Pjesa më e madhe e të anketuarve shprehen të kënaqur nga qëndrimi dhe sjellja e gjyqëtarëve dhe prokurorëve (61%), gjuha e përdorur nga gjyqëtarët dhe prokurorët (61%) dhe nga qartësia e vendimeve gjyqësore (63%).

Në terma të përgjithshme publiku e vlerëson të qartë funksionimin e gjykatës (74%) kundrejt 23% që e vlerëson si jo transparente.


Publiku i anketuar shprehet se nuk është tërësisht i kënaqur me paanshmërinë e gjykatës, 80% e të anketuarve shprehen se gjykata është disi apo jo e paanshme. Lidhur me kohëzgjatjen e vendimeve të dhëna prej saj 53% e të anketuarit shprehen se shpejtësia është e ngadaltë kundrejt 40% që shprehen me një qëndrim normal. . Publiku i vlerëson si të larta kostot e aksesit në drejtësi (71%). Burimet në dispozicion të gjykatës vlerësohen të mjaftueshme në 73% të rasteve. Ndërkohë që mundësia e informimit për të drejtat e tyre vlerësohet 50% e vështire kundrejt 49% që shprehen që kjo mundësi është mjaft e lehtë.

A. Si e vlerësoni paanshmërinë e gjyqtarëve në zhvillimin e seancave gjyqësore me gojë?




■ Si e vlerësoni paanshmërinë e gjyqtarëve në zhvillimin e seancave gjyqësore me gojë?

B. Cili është vlerësimi juaj i shpejtësisë të trajtimit të çështjes tuaj nga gjykata?




■ Cili është vlerësimi juaj i shpejtësisë të trajtimit të çështjes tuaj nga gjykata?

C. Në terma të përgjithshme, si e vlerësoni funksionimin e gjykatave?




■ Në terma të përgjithshme, si e vlerësoni funksionimin e gjykatave?

D. Pa marrë parasysh tarifat e avokatit, si i vlerësoni kostot e aksesit e drejtësisë?




■ Pa marrë parasysh tarifat e avokatit, si i vlerësoni kostot e aksesit e drejtësisë?

E. Bazuar në përvojën tuaj, si i vlerësoni burimet në dispozicion të gjykatës?



■ Bazuar në përvojën tuaj, si i vlerësoni burimet në dispozicion të gjykatës?

F. Në përgjithësi, si e vlerësoni mundësinë e informimit për të drejtat tuaja?



■ Në përgjithësi, si e vlerësoni mundësinë e informimit për të drejtat tuaja?

7. REZULTATET E MONITORIMIT

Në studimin tonë janë trajtuar dhe analizuar rreth 30 çështje civile të trajtuara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, 10 intervista të realizuara me aktore të cilët operojnë pranë kësaj gjykate të tillë si gjyqtarë, staf administrativ dhe avokatë në rolin e palës në proceset gjyqësore si dhe 130 pyetësore të plotësuara nga palët pjesëmarrëse në proceset gjyqësore të zhvilluara pranë kësaj gjykate. Gjithashtu një vënd të rëndësishëm në këtë projekt zë dhe analizimi i kuadrit ligjor institucional të gjykatës.

- ❖ Përsa i përket **kuadrit ligjor** të analizuar vëme re se në **Rregulloren e Brendshme** të Gjykatës:
- Duhet të përmirësohet dhe të përputhet me zhvillimin e institucionit dhe të kompetencave të tij (kujtojmë se rregullorja është miratuar që në vitin 2013)
 - Mungon dixhitalizimi i të gjitha akteve të administruara nga gjykata në servera përkatës në mënyrë që të rritet efikasiteti i kohës në proceset gjyqësore;
 - Vihet re një mospërputhje të lehtë ndërmjet organigramës aktuale të gjykatës dhe parashikimeve të bëra në këtë rregullore. Kështu përshëmbull vlen të përmendet mos parashikimi i detyrave funksionale të Kancelarit të Gjykatës në rregulloren e miratuar në vitin 2013. Ashtu siç dhe shprehet vetë dhe rregullorja, për shkak se në periudhën e miratimit të saj nuk ishte parashikuar në organik pozicioni i Kryesekretarit, shpesh herë në këtë akt do të gjejmë të konfunduar detyrat dhe veprimtarin e Kancelarit me atë të Kryesekretarit të gjykatës. Për këtë arsye sygjerojmë rregullimin e këtij momenti me anë të një amendimi, i cili do të reflektoj më saktësishtë organikën aktuale të vet Gjykatës.

Në Rregulloren për Përdorimin e Pajisjeve Elektronike të GJRRGJL duhet të përfshihen pikat si më poshtë vijnë:

- Përcaktimit të llojit të informacionit që do të qarkulloje/ ruhet në pajisjet teknologjike;
- Mënyrën dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së informacionit i cili regjistrohet nga këto pajisje;
- Proedurën e arkivimit të seancave gjyqësore të regjistruara me sistem audio, dhe aksesimin e këtyre materialeve në bazë të kërkesave të palëve të legjitimuara;
- Shpërndarjen e saktë të pajisjeve teknologjike në ambientet e gjykatës

Gjithashtu gjatë fazave të projektit kemi konstatuar këto të dhëna sasiore në lidhje me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje:

1. Gjyqëtarët të cilët ushtrojnë detyrën aktualishtë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje janë:
 - Esmeralda Çeka Gjyqëtare prej vitit 2007
 - Saemira Hila Gjyqëtare prej vitit 1998
 - Zeta Tërpollari Gjyqëtare prej vitit 2009
 - Ersida Bajgora Gjyqëtare prej vitit 2017
2. Numri total i zyrave të ndara për gjyqëtarët dhe administratën e Gjykatës:
 - Zyra për gjyqëtarë 4
 - Zyra e Kryetarit 1
 - Zyra për administratën⁸ 9

⁸ Nga të cilat 1 zyrë përdoret për psikologun dhe 1 zyrë përdoret për Shërbimin e Provës.

3. Numri i sallave të pajisura me audio në funksion të seancave gjyqësore:
 - 4 Salla në total të pajisura me sistemin audio⁹
4. Numri ose përqindja e përafërt e seancave gjyqësore që janë zhvilluar në sallë të pajisur me sistemin audio dhe ato të zhvilluara në zyrën e gjyqëtarit në dy vitet e fundit kalendarik (2016-2017):
 - Për vitin 2016 janë zhvilluar 8157 seanca audio dhe 182 seanca në zyrën e gjyqëtarit (me një përqindje prej 97.7% të seancave të zhvilluara në sistem audio)
 - Për vitin 2017 janë zhvilluar 6711 seanca audio dhe 326 seanca në zyrën e gjyqëtarit¹⁰ (me një përqindje prej 95% të seancave të zhvilluara në sistem audio)

OS1. Vlerësimin e perceptimit të qytetarëve dhe bizneseve në lidhje me cilësinë e shërbimeve gjyqësore dhe komunikimeve gjyqësore.

Nga analiza e pyetësorëve të shpërndarë pranë kësaj gjykate rezulton se:

- Publiku nuk ka besim të plotë tek garantimi i së drejtës nga institucioni i gjykatave në vlerën mbi 45%.
- Publiku konsideron si të rëndësishëm kushtet e infrastrukturës së godinës së gjykatës ku përfshihet këtu mobilimi i sallave gjyqësore dhe ato të pritjes por vihet re një ndjeshmëri (mesatarisht e rëndësishme) e tij përsa i përket çështjeve të lehtësirave të aksesit në gjykatë, qartësisë së fletëthirrjeve dhe njoftimeve, periudhës kohore ndërmjet njoftimit dhe seancës gjyqësore, korrektësisë së seancave gjyqësore. Nga pyetësorët rezulton se publiku është pjesërisht i kënaqur me pikat e mësipërme.
- Publiku është i ndjeshëm ndaj raportet dhe komunikimin me administratën e gjykatës, gjyqëtarët dhe prokurorët, qëndrimin dhe sjelljen e stafit të gjykatës (administrativ dhe gjyqësorë) dhe prokurorëve, nivelin e kompetencës së stafit jo-gjyqësor të gjykatës.
- Publiku ka listuar si shumë të rëndësishme: periudhën kohore ndërmjet njoftimit të seancës gjyqësore, korrektësinë e mbarëvajtjes së seancës, gjuha e përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët, kohën e lejuar për të parashtruar argumentet gjatë një seance gjyqësore, koha dhe afati kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore, qartësinë e vendimeve gjyqësore, informacioni i dhënë nga shërbimi i informacionit të gjykatës;
- Nga pyetësorët rezulton se qytetarët janë të kënaqur nga qartësia e fletë thirrjeve (njoftimeve) por shprehin pakënaqësi për periudhën kohore ndërmjet seancave gjyqësore;
- Publiku shprehet i kënaqur nga qëndrimi, korrektësia, informacioni i dhënë dhe kompetenca e stafit të gjykatës;
- Publiku i anketuar shprehet se nuk është tërësisht i kënaqur me paanshmërinë e gjykatës dhe me cilësinë dhe kohëzgjatjen e vendimeve të dhëna prej saj;

⁹ Nga të cilat 3 salla përdoren për proceset civile dhe 1 sallë për proceset penale.

¹⁰ Sipas të dhënave na rezulton që pjesa me madhe e seancave të zhvilluara në zyrën e gjyqëtarit kanë qënë Urdhëra Ekzekutimi.

- Publiku i vlerëson si të larta tarifat e avokatit si dhe kostot e aksesit në drejtësi.

Vëme re se kryesisht mosha e të anketuarve varjon nga 30 deri në 60 vjeç prej të cilëve pjesa më e madhe ishin të gjinisë mashkullore. Anketimi i tyre është bërë në ditë të ndryshme pune të Gjykatës dhe pa preferenca për zgjedhjeje. Më shumë se 50% e të anketuarve rezultojnë me arsim të mesëm dhe vetëm 21% me arsim të lartë (kjo e dhënë mund të shërbejë si referencë për një studim nëse kjo shtresë e shoqërisë i drejtohet më parë ndërmjetësimit sesa gjykatës për zgjidhjen e mosëmarrëveshjeve të ndryshme), pjesa më e madhe e të cilëve rezultojnë palë e interesuar në një proces gjyqësor të zhvilluar pranë kësaj gjykate (palë paditëse ose të paditur).

OS2. Intervistimi i zyrtarëve të gjykatës civile për të identifikuar sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë punës së tyre të përditshme.

Nga analizimi i intervistave të kryera gjatë këtij projekti **me punonjësit** e Gjykatës na rezultojnë si gjetje pozitive të punës si më poshtë vijojnë:

- Rritja e sigurisë në Gjykatë;
- Shërbimi cilësor ndaj publikut dhe rritja e aftësive profesionale të administratës gjyqësore;
- Paanshmëria e gjyqtarëve;
- Trajnimi i herëpashershëm dhe i domosdoshëm i gjyqtarëve;

Ndërsa vështirësitë që paraqiten gjatë përditshëmerisë së kësaj Gjykate nga këto intervista rezultojnë si më poshtë vijojnë:

- Numri i reduktuar i gjyqtarëve të parashikuar në organigramën e Gjykatës;
- Mosplotësimi me gjyqtarë i organigramës së gjykatës;
- Ngarkesa maksimale me procese gjyqësore të gjykatësve;
- Mosndarja në seksione civile dhe penale e gjyqtarëve;
- Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për shkak të numrit të reduktuar të gjykatësve dhe ngarkesës që ato kanë;
- Vështirësi në rritjen e kredibilitetit që ka publiku në sistemin gjyqësor në përgjithësi;
- Ngarkesa e madhe e punës con në kohëzgjatje të papaguar të orarit të punës (deri në 10 orë punë në ditë + fundjava)
- Për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve pranë kësaj gjykate shpesh herë ka lindur nevoja për delegimin e gjyqtarëve nga rrethet e tjera për plotësimin e trupave gjyqësorë që ka cuar në zvarritjen e proceseve gjyqësore.
- Mos ndarja në mënyrë të qatë të detyrave funksionale të kryetarit dhe kancelarit të gjykatës;
- Mos përcaktimi i qartë i detyrave të IT në institucion;
- Vështirësi në identifikimin e adresave të sakta të palëve, sidomos për të paditurin në procesin civil;

- Mos atashimi i sekretarëve me një gjyqtar por lëvizja e tyre nga një gjyqtar në tjetrin sipas nevojave të institucionit;
- Paga jo në përputhje me ngarkesën dhe funksionet.

Nga intervistat e bëra **me avokatët** të cilët kanë operuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje rezulton se vështirësit dhe problematikat kryesore të kësaj Gjykate janë si më poshtë vijojnë:

- Numri i reduktuar i gjyqtarëve të parashikuar në organigramën e Gjykatës;
- Mosplotësimi me gjyqtarë i organigramës së gjykatës;
- Ngarkesa maksimale e gjyqtarëve me procese gjyqësore con në kohëzgjatjen tej afateve ligjore të parashikuara dhe zvarritje të çështjeve gjyqësore. Rrethana këto që shpesh shkaktojnë thellimin e konflikteve ndërmjet palëve;
- Mënyrat e njoftimit të palëve në një proces gjyqësor, të cilat shpesh herë janë jo efikase për shkak të vonesave që shkaktojnë;
- Mospasja e një sistemi online njoftimesh;
- Distanca e gjatë kohore nga njëra seancë gjyqësore në tjetrën;
- Afati i gjatë i përfundimit të një procesi gjyqësor për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve dhe ngarkesës së punës që ato kanë;
- Numri në rritje i senacave joefektive për shkak të mos njoftimit në kohë të palëve apo mungesave të gjyqtarëve;

OS3. Analiza e treguesve për ecurinë e çështjeve civile të nxjerra nga gjykata e shkallës së parë në Lushnjë.

Përsa i përket çështjeve të analizuara në këtë projekt nga studimi i tyre na rezulton se:

- Numri minimal i seancave për çështje gjyqësore është 3;
- Numri maksimal i senacave për çështje gjyqësore është 7;
- Kohëzgjatja minimale nga njëra seancë në tjetrën është 15 ditë pune;
- Kohëzgjatja maksimale nga njëra senacë në tjetrën është 30 ditë pune;
- Seancat efektive janë më të shumta në numër se seancat joefektive (mbi 50% të seancave);
- Arsyeja kryesore e shtyrjes së seancave është mosparaqitja e palëve për shkak të vonesës apo mungesës së njoftimeve;
- Nuk rezulton asnjë vendim i ndërmjetëm në këto çështje gjyqësore;
- Pjesa më e madhe e vendimeve janë në favor të palës paditëse;
- Të gjitha vendimet e dhëna kanë marrë formë të prerë.

Nga sa më sipër rezulton se një riorganizim sa më i shpejt i strukturës dhe organikës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje është i domosdoshëm për mbarëvajtjen dhe funksionimin sa më optimal të kësaj gjykate. Në këtë gjykatë vihen re mangësi në organike, strukturë dhe funksionim të saj për shkak të mjeteve jo të përdituara me të cilat operon kjo gjykatë sidomos për njoftimet e palëve në një proces gjyqësor.

Nga analiza e gjithë procesit të mësipërm vëm re disa problematika kryesore të mbarëvajtjes të të gjithë procesit të punës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, të cilat po i parashtrijmë si më poshtë vijojnë:

- **Organika e reduktuar** e kësaj gjykate si në staf gjyqësor dhe atë administrativ. Kështu organika e kësaj gjykate parashikon që në këte institucion të ushtrojnë detyrën e gjyqtarit 5 të tillë. Konkretisht gjatë periudhës tonë të monitorimit kjo gjykatë ka funksionuar me 4 gjyqtarë dhe ka një vënd vakant. Nga informacionet që kemi marrë për një periudhë kohore kjo gjykatë ka funksionuar me dy ose tre gjyqtarë për shkak të mungesës së arsyetuar të gjyqtarëve të tjerë¹¹. E gjitha kjo situatë ka kontribuar në mbingarkesën maksimale të gjyqtarëve në detyrë duke i ngarkuar ato me mbi 750-800 çështje në vit si rrjedhojë vihet re një cedim në kohëzgjatjen proceseve gjyqësore me shkak kryesor volumin e madh të punës së secilit gjyqtarë. Kjo ka qënë dhe një nga arsyt kryesore të mos respektimit të një afati të arsyeshëm dhe të ligjshëm për përfundimin e një procesi gjyqësorë, duke ndikuar jo vetëm në vijimin e procesit por dhe në fazën e vendimarrjes (përmëndim këtu kohëzgjatjen e zbardhjes së vendimeve gjyqësore gjë që ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në procesin e ankimimit dhe afateve të tij).

Gjykojmë se kjo mbingarkesë e stafit gjyqësor pranë kësaj gjykate ka ndikuar jo vetëm në kohëzgjatjen e proceseve por edhe në cilësinë e vendimeve të marra.

- **Kohëzgjatja e gjykimeve dhe seancat joefektive.** Kohëzgjatja e çështjeve gjyqësore shpeshherë cënon të drejtën e palëve për një gjykim të drejtë duke përfshirë edhe të drejtën për gjykim brënda një afati kohor të arsyeshëm. Kështu llogaritja e afatit kohor fillon që nga çasti kur çështja i referohet autoritetit gjyqësor kopetent dhe konsiderohet i përfunduar pas marrjes së një vendimi (të formës së prerë). Për secilin nga proceset e analizuara u zhvilluan mesatarisht 4.5 seanca gjyqësore ku rreth 45% e tyre ishin totalisht joefektive (jo produktive) dmth nuk ka ndodhur asgjë thelbësore për të zgjidhur mosmarrëveshjen civile object gjykimi. Në këto seanca arsyeja kryesore e joproduktivitetit të tyre ishte kryesisht mos marrja ose vonesa në njoftime të palëve. Element ky totalisht administrativ dhe lehtësisht i kapërcyeshëm nga ky institucion. Gjykata shpesh është hasur me problemin e njoftimit të rregullt të palëve të thirrura në seancë, për shkak të adresave jo të sakta dhe mungesës së aksesit në databazat e adresave në nivel qëndror dhe vendor. ***Nga sa më sipër vëme re se institucioni jo gjithmonë ka përdorur mënyrat më të shpejta të njoftimit, të lejuara me ligj.*** Gjatë analizës së çështjeve civile u konstatua se një nga shkaqet kryesore të kohëzgjatjes së seancave është dhe ***mbingarkesa e gjyqtarëve me procese gjyqësore.*** Duke patur fluks dhe volum të madh të çështjeve që kanë në shqyrtim gjyqtarët caktojnë seancat gjyqësore me diferencë kohore të gjatë midis njëra tjetrës. Pavarësisht se u vu re konsultimi paraprak i gjyqtarëve me palët pjesëmarrëse në proces për vendosjen e një kalendarit të seancave pasëardhëse u konstatua që ngarkesa e gjyqtarëve kishte influencën më të madhe në caktimin e datave pasardhëse. Një arsye tjetër për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore të analizuara kanë qënë dhe ***seancat përgatitore shpesh jo efikase*** (rreth 20% të seancave janë shtyrë për shkaqe të lidhura me provat). Shpesh herë, provat nuk u paraqitën në momentin më të parë të mundshëm, por u lanë për më vonë.

Një element tjetër që vihet re në shtimin e numrit të seancave jo efektive pranë kësaj gjykate është dhe ***mungesa e pjesëmarrësve (palëve, ekspertëve, etj) në proceset gjyqësore.*** Gjithashtu, kriteret për sanksionimin e pjesëmarrësve që mungojnë në gjykim janë shumë të paqarta. Edhe Kodi i Procedurës Civile nuk përcakton qartë një procedurë që duhet ndjekur nga gjykatat për të përcaktuar shkaqet e mosparaqitjes së pjesëmarrësve në gjykim. Kjo bën që gjyqtarët të hezitojnë për të vendosur sanksione ndaj pjesëmarrësve që mungojnë në gjykim. Edhe ato sanksione që u

¹¹ Leje lindje

përdorën në rastet e vëzhguara ishin shumë të buta dhe gjyqtarët nuk dukej se i përdorin plotësisht. Sistemi disiplinor për avokatët nuk duket të ishte plotësisht funksional. Ndërkohë, palët pjesëmarrëse në gjykim nuk janë të detyruara me ligj të njoftojnë gjykatën përpara seancës nëse nuk mund të jenë të pranishëm, duke bërë që pjesëmarrësit e tjerë të paraqiten kot në seancë. Gjatë procesit të monitorimit të seancave gjyqësore pranë kësaj gjykate kemi vënë re se shpesh herë procesi gjyqësor zgjatet në kohë për shkak të mosparaqitjes në seancë të palës së paditur apo paditëse. Gjykata pasi verifikon “ligjshmërinë” dhe arsyen për mosparaqitjen e palës vendos shtyrjen e seancës në një afat të ri. Shtyrjet e seancave gjyqësore bëhen kur:

- *Mungon pala paditëse.* Gjykata heton nëse ka një shkak të arsyeshëm apo të ligjshëm¹² (kemi konstatuar që rasti më is shpesht i pranuar nga gjykata janë raportet mjeksore). Nëse pala paditëse nuk i krijon bindjen e brëndshme gjykatës se ka një arsye të pranueshme për mosparaqitjen e palës, gjykata vendos pushimin e çështjes, e cila nuk e pengon paditësin të ringrej sërish çështjen pranë kësaj gjykate, penalteti i vetëm është riaplikimi i tarifave gjyqësore.

- *Mungon pala e paditur.* Gjykata heton nëse ka shkak të arsyeshëm apo ligjshëm për mungesën e palës. Nga vëzhgimi jonë rezulton se gjykata ka në konsideratë të njëjtat shkaqe si për palën paditëse. Nëse gjykata konstaton se mungesa e palës është e paarsyeshme me kërkesë të palës paditëse vazhdon gjykimin.

- *Mungon ekspert.* Në rast se mungesa e tij rezulton e paarsyetuar (gjykata merr parasysh shkaqet e sipër cituara dhe ndonjëherë dhe përplasjet e thirrjeve gjyqësore), gjykata mund ta gjobisë atë në vlerë deri 300.000 lekë.

Në rastet e ndjekura prej nesh nuk është marrë asnjëherë një sanksion i tillë.

Në të gjitha rastet e mësipërme gjykojmë që neglizhenca apo pasiviteti i gjykatës për të marrë masa konkrete e drastike për palët që pa të drejtë zvarrisin procesin gjyqësor penalizon të gjithë procesin dhe ndikon në kohëzgjatjen e tij¹³.

- ***Mos ndarja e gjyqëtarëve në dhoma.*** Numri i reduktuar i gjyqëtarëve pranë kësaj gjykate e ka bërë të pamundur ndarjen e gjyqëtarëve në dhomë civile dhe dhomë penale. Kështu një gjyqtari brënda një dite mund t'i rastisë (probabiliteti është shumë i lartë) të gjykojë dhe çështje civile dhe çështje penale, gjë që shpesh herë mund ta konfundojë atë pasi një gjyqtar nuk mund të jetë specialist i të gjitha çështjeve juridike të adresuara pranë një gjykate. Një praktikë të mirë e shohim tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila jo vetëm trajton vetëm dhe ekskluzivisht çështje civile por gjyqëtarët janë të ndarë në sesione (psh: gjyqtarë që merren vetëm me çështje familjare, tregtare, etj). Gjykojmë që ky konfondim i çështjeve brenda ditës së punës së një gjyqtari ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e vendime të dhëna prej tyre.
- ***Mungesa e sesionit për të mitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje.*** Për shkak të numrit të reduktuar të gjyqëtarëve pranë kësaj Gjykate vihet re mungesa e një sesioni për zhvillimin e seancave gjyqësore me palë pjesëmarrëse të miturin. Organika e vogël në numër nuk mundëson specializimin dhe ndarjen e gjyqëtarëve për këtë sesion. Për këtë arsye të gjitha çështjet gjyqësore më palë të miturin i referohen gjykatave fqinje të cilat kanë sesionin përkatës (kryesisht Gjykatës së Vlorës.)
- ***Problematikat në komunikimin e njoftimeve*** ndërmjet palëve në proceset gjyqësore. Thirrja jo e suksesshme e pjesëmarrësve në gjykim përbënte një shkak të vazhdueshëm për

¹² Kodi i Procedurës Civile nuk saktëson se cili mund të quhet shkak i ligjshëm përveç sëmundjeve

¹³ Një nga postulatet më të rëndësishme në systemin e drejtësisë është “Drejtësi e vonuar drejtësi e munguar”

shtyrjen e seancave duke rritur kështu artificialisht kohëzgjatjen e procesit gjyqësorë dhe numrin jo efektiv të seancave. Pjesëmarrja e palëve gjatë procesit gjyqësorë në shumicën e herëve është e detyrueshme për zhvillimin e seancës gjyqësore.

Nga hulumtimi që bëme gjatë të gjitha fazave të projektit vumë re se kjo problematikë rrjedh si shkak nga disa faktorë të cilët po i listojmë më poshtë:

- Vështirësi për të gjetur adresën e saktë për shkak të sistemit të ri të adresave
- Informacion i paplotë rreth adresës së palës së paditur;
- Gjykata nuk ka akses në Rregjistrin Kombëtar të Gjëndjes Civile dhe Rregjistrin Kombëtar të adresave, gjë që do të lehtësonte identifikimin e adresave të sakta për cdo palë pjesëmarrëse në një proces gjyqësor;
- Mospërdorimi nga ana e gjykatës i mjeteve të shpejta të njoftimit të lejuara nga legjislacioni;
- Pasiviteti i gjykatës për të përdorur mjete alternative njoftimi kur thirrja e parë rezultoi e pa sukseshme;
- Mos bërja publike e njoftimeve me shpallje.

Pavarësisht gjetjeve dhe problematikave të cituara në këtë raport mbetet për t'u vlerësuar angazhimi maksimal dhe profesional i stafit administrativ dhe gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Të cilët edhe pse nën trysnin e mbingarkesës dhe fluksit të madh të punës kanë arritur që të kenë një mbarëvajtje normale të proceseve dhe rendit të ditës në këtë institucion.

Përvec sa më sipër mbetet për tu vlerësuar si fakt pozitiv prania pranë kësaj gjykate të një dhome të dedikuar për psikologun në rastet ku një i mitur është i përfshirë në një proces gjyqësor. Theksojmë se ky element është pozitiv për këtë gjykatë pasi nuk haset shpesh nëpër simotrat e saj në rrethe të tjera të RSH.

8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga sa parashtruam me sipër në këtë raport vëmë re që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje vuan pasojat e mbingarkesës me çështje të ndryshme civile dhe penale, rrjedhojë kjo e numrit të pakët të gjyqëstarëve të atashuar pranë kësaj gjykate. Kjo mbingarkesë e zgjatur në kohë ka reflektuar tek kohëzgjatja e proceseve gjyqësore dhe tek cilësia e vendimeve të dhëna. Mendojmë se zgjerimi i organigramës me gjyqëtarë të tjerë do të ishte faktor kryesor për përmirësimin e kësaj problematike në këtë institucion.

Gjithashtu faktor tjetër i cili ndikon në cilësinë e proceseve gjyqësore të zhvilluara na rezulton dhe mos ndarja e gjyqëtarëve në dhoma civile dhe penale. Kjo gjë do të ndikonte në specializimin e gjyqëtarëve në një fushë të caktuar dhe do të përmirësonte dukshëm cilësinë e vendimeve gjyqësore dhe kohëzgjatjen brënda afateve ligjore të proceseve. Mendojmë që me rritjen e numrit të gjyqëtarëve në organikën e kësaj gjykate ndarja e tyre në dhoma është lehtësisht e realizueshme dhe do të përmirësonte mbarëvajtjen e këtij institucioni.

Një problematike tjetër e konstatuar është ajo e njoftimeve të palëve pjesëmarrëse në një proces gjyqësor. Është konstatuar se një nga faktorët kryesorë të kohëzgjatjes dhe zvarritjes së një procesi kryesisht civil është ajo e njoftimit të palëve. Gjykata shpesh herë është vënë në vështirësi për të vazhduar normalisht procesin për shkak të mos realizimit të njoftimit të palëve pjesëmarrëse apo vonesave në njoftimin e tyre. Kemi konstatuar se jo gjithmonë gjykata i është referuar të gjitha rrugëve ligjore të njoftimit të palëve. Si rrjedhojë për shkaqe dhe të pavarura nga gjykata si përshëmbull mos dhënia e saktë e adresës, mos përditësimi i adresës në rast lëvizje apo mungesa e saj ka shtuar numrin jo efektiv të seancave gjatë një procesi gjyqësor. Nga monitorimi i disa seancave gjyqësore kemi vënë re se gjykata përdor kryesisht njoftimet e kryera me postë pranë vendbanimit apo vendqëndrimit të deklaruar të palëve. Njoftimi i palës me mjeta më të shpejta komunikimi do t'i shërbente jo vetëm procesit por edhe punës së vet gjykatës, duke e zhveshur atë nga kryerja e seancave joefektive për këtë shkak.

Për sa më sipër mendojmë se puna e kësaj Gjykate do të kishte rezultate më të mira në rast përmirësimi të faktorëve të konstatuar gjatë këtij procesi monitorimi. Kjo gjë do të shërbente jo vetëm këtij institucioni dhe palëve të proceseve gjyqësore të zhvilluara në të, por do të reflektonte dhe në të gjithë sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

Duke marrë parasysh që një nga shtyllat kryesore të përmirësimit të funksionimit të gjykatës është zgjerimi i organikës së saj ftojmë organet kompetente të reflektojnë këto ndryshime sa më parë.

2. REKOMANDIME

Në përfundim të këtij raporti gjejmë me vënd të rendisim disa rekomandime të cilat kanë dale si rezultat i monitorimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje për rreth një vit kalendarik nga ana jonë, si më poshtë vijon:

- Të zgjerohet organigrama e institucionit me staf administrativ dhe gjyqësor;
- Të bëhet ndarja e gjyqëtarëve në dhoma civile dhe penale;
- Të krijohet një sesion për çështje gjyqësore me të mitur;
- Të reduktohet numri i çështjeve të trajtuara nga gjyqëtarët në një vit kalendarik;
- Të detyrohen pjesëmarrësit në seancat gjyqësore t'i japin gjykatës të dhëna të detajuara kontakti;
- Kryetari i seancës të jetë përgjegjës për garantimin e thirrjes së palëve në gjyq;
- Gjykata të përdorë të gjitha mjetet ligjore për të njoftuar palët pjesëmarrëse (ato elektronike apo telefonike si mjete më të shpejta e të sigurta të komunikimit)
- Gjykata duhet të vendose akses në hartat ekzistuese të pushtetit qendror dhe atij vendor;
- Gjykata duhet të ketë mundësi të përdorin Rregjistrin Kombëtar të Gjëndjes Civile dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave;
- Policia e Shtetit duhet të asistojë në njoftimin e palëve kur kjo shihet e arsyeshme për shkak të refuzimit të marrjes së njoftimit të herë pas hershëm;
- Njoftimet publike të bëhen online;
- Gjykata të verifikojë disponueshmërinë e palëve përpara se të caktojnë seancën e radhës;
- Të vendoset një procedurë për hetimin e arsyeve të mungesës së palëve në proces;
- Sqarimi i shkakut të ligjshëm të mos paraqitjes;
- Njoftimi sa më i shpejt nga gjykata (me mjete elektronike apo telefonike) të anulimit të seancës gjyqësore;
- Detyrimi i palëve pjesëmarrëse të njoftojnë paraprakisht mungesën e tyre në gjykim;
- Kohëzgjatja e procesit gjyqësorë të jetë element vlerësimi i punës së gjyqtarit;
- Standartizimi i llogaritjes së kostove për vonesat e pajustificuara;
- Ngarkimi i ekspertëve apo dëshmitarëve me kostot e vonesës;
- Vendosja e gjobave për palët që mungojnë më shumë se dy herë gjatë një procesi gjyqësor;
- Shpallja e vendimit duhet të bëhet vetëm atëherë kur vendimi është i arsyetuar (zbardhet);
- Vendimet duhet t'u njoftohen palëve duke i pajisur ato me kopje të shkruar;
- Afatet e ankimit duhet të fillojnë kur pala është pajisur me kopjen e vendimit të arsyetuar;
- Duhet të krijohet një sistem për regjistrimin e datës kur palët marrin vendimin e arsyetuar;
- Përmirësimi i infrastrukturës, sallave ku zhvillohen seancat gjyqësore me mjete sigurie;
- Përmirësimi i sallave, holleve për pritjen e publikut duke i pajisur ato me mjete elektronike ku të shfaqen orari i seancave gjyqësore, ndryshimet apo anulimet e seancave;
- Përmirësimi i godinës me akses për personat me aftësi të kufizuar (tetra dhe paraplegjikët);
- Parashikimi i disa lehtësirave për të konsultuar dosjet gjyqësore;
- Tabela e përmbajtjes së çështjes gjyqësore duhet të jetë me i detajuar;
- Transkriptimi i seancave audio në procesverbale të shkruara, të aksesueshme online për publikun e interesuar;

ANEKS 1.

ANKETA E KËNAQËSISË SË PËRDORUESVE TË GJYKATËS

I/E nderuar

Instituti i Politikave të Qendrueshme është një Organizatë Jo Fitimprurese dhe Jo Qeveritare e cila po zbaton projektin: "Monitorimi i funksionimit të Gjykatës Civile të Shkallës së Parë në Lushnje". Ky projekt është pjesë e skemës së granteve të projektit "Përfshirja qytetare për një sistem gjyqësor të hapur dhe funksional" i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Objektivi i përgjithshëm: Të vlerësojë cilësinë e shërbimeve juridike dhe gjyqësore të ofruara nga gjykata civile e shkallës së parë të Lushnjës. Projekti synon të adresojë çështjet kryesore që ndikojnë në cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor shqiptar, por me një fokus të veçantë në gjykatën e rretheve të zonave të largëta të cilat mund të përballen me problematika të veçanta.

Ky pyetësor është pjesë e vlerësimit të cilësisë së sistemit të drejtësisë që fokusohet në veçanti tek cilësia e shërbimeve dhe funksionimi i Gjykatës Civile të shkallës së parë në Lushnje.

Opinionet dhe sugjerimet tuaja janë të rëndësishme për ne dhe do të ishim mirënjohës nëse do t'u kushtonit pak kohë dhe do t'u përgjigjeni pyetjeve më poshtë. Pyetësi është anonim dhe ne garantojmë se përgjigjet tuaja do të trajtohen me fshehtësinë më të madhe.

Duke ju falenderuar paraprakisht

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. Gjinia

- ☐ Mashkull
- ☐ Femër

2. Mosha

- ☐ 18-30
- ☐ 31-50
- ☐ 51-65
- ☐ 66 dhe mbi 66

3. Arsimi

- ☐ 8/9-vjecar
- ☐ I mesëm
- ☐ I lartë

Ju lutemi të shënoni kutinë e duhur

4. Cilat janë arsyet për të cilat i jeni drejtuar Gjykatës Lushnje:

- ☐ Palë e procesit gjyqësor
- ☐ Dëshmitar
- ☐ Tjetër (p.sh. familjar i njërës prej palëve, i interesuar për informacion, vizitor etj.)
- ☐ Për të marrë informacion para depozitimit të kërkesë padisë
- ☐ Për të depozituar një kërkesë padi
- ☐ Vërtetime
- ☐ Vendime
- ☐ Prapësime
- ☐ Ankimime & Rekurse
- ☐ Të marrë pjesë në seancë dëgjimore/gjyqësore
- ☐ Të marrë informacion mbi ecurinë e dosjes

5. Në cilën lloj procedure bazohej çështja për të cilën ju shkuat në gjykatë?

- ☐ procedura civile
- ☐ procedura administrative
- ☐ procedura tregtare
- ☐ e drejta e punës
- ☐ procedura penale
- ☐ tjetër (i mitur, kujdestari, pensione, regjistër, etj.).

Ju lutemi të specifikoni:

☐ Nuk e di

[pyetje me dëshirë]

6. Sa është niveli i besimit tuaj tek sistemi i drejtësisë?

Shumë i ulët	I ulët	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë
☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5

7. Nëse keni qenë palë, dhe vendimi është dhënë, a ka vendosur gjykata pjesërisht apo plotësisht në favorin tuaj?

☐ po, plotësisht

☐ po, pjesërisht

☐ jo

☐ nuk kam qenë palë

8. A u zhvilluan seancat gjyqësore në gjuhën tuaj amtare?

☐ po (shko tek 10)

☐ jo

9. Nëse seanca nuk është zhvilluar në gjuhën tuaj amtare, a u caktua një përkthyes?

☐ po

☐ jo

10. Vlerësoni rëndësinë që u jepni elementëve të mëposhtëm:

	E parëndësishme	Jo shumë e rëndësishme	Mesatarisht e rëndësishme	E rëndësishme	Shumë e rëndësishme	Asnjë përgjigje
10.1 Kushtet e aksesit në gjykatë	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.2 Shënimet në ndërtesën e gjykatës	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.3 Kushtet e pritjes	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.4 Mobilimi i sallës së gjykimin	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.5 Qartësia e fletë-thirrjeve dhe njoftimeve	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.6 Periudha kohore ndërmjet njoftimit dhe	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6

seancës gjyqësore						
10.7 Korrektësia e seancës gjyqësore	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.8 Qëndrimi dhe sjellja e stafit të gjykatës	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.9 Niveli i kompetencës së stafit jo-gjyqësor të gjykatës	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.10 Qëndrimi dhe sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.11 Gjuha e përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.12 Koha e lejuar për të parashtruar argumentet tuaja në seancë	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.13 Afati kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
10.14 Qartësia e vendimeve gjyqësore	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6

[Elementë me dëshirë:]

10.15 Informacioni i dhënë nga shërbimi i informacionit i gjykatës	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5	☐ 6
--	----------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------

11. Vlerësoni shkallën e kënaqësisë në lidhje me elementët e mëposhtme:

	i pakënaqur	jo shumë i kënaqur	disi i kënaqur	i kënaqur shumë	Asnjë përgjigje
11.1 Kushtet e aksesit në gjykatë	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5
11.2 Shënimet në ndërtesën e gjykatës	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5

11.3 Kushtet e pritjes	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.4 Mobilimi i sallës së gjyimit	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.5 Qartësia e fletëthirrjeve	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.6 Periudha kohore ndërmjet njoftimit dhe seancës gjyqësore	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.7 Korrektësia e seancës gjyqësore	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.8 Qëndrimi dhe sjellja e stafit të gjykatës	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.9 Niveli i kompetencës së stafit jo-gjyqësor të gjykatës	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.10 Qëndrimi dhe sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.11 Gjuha e përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.12 Koha e lejuar për të parashtruar argumentet tuaja në seancë	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.13 Afati kohor për dhënien e vendimeve gjyqësore	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
11.14 Qartësia e vendimeve gjyqësore	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆

[Elementë me dëshirë:]

11.15 Informacioni i dhënë nga shërbimi i informacionit i gjykatës	☐ ₁	☐ ₂	☐ ₃	☐ ₄	☐ ₅	☐ ₆
--	---------------------------------------	---------------------------------------	---------------------------------------	---------------------------------------	---------------------------------------	---------------------------------------

[Pyetje me dëshirë:]

12. Në terma të përgjithshme, si e vlerësoni funksionimin e gjykatave?

shumë jo jo transparent të qartë shumë të qartë

transparent

☐ 1

☐ 2

☐ 3

☐ 4

13. Si e vlerësoni paanshmërinë e gjyqtarëve në zhvillimin e seancave gjyqësore me gojë?

aspak të
paanshme

☐ 1

jo shumë të
paanshme

☐ 2

disi të paanshme

☐ 3

tërësisht të
paanshme

☐ 4

14. Cili është vlerësimi juaj i shpejtësisë të trajtimit të çështjes tuaj nga gjykata?

shumë i ngadaltë

☐ 1

i ngadaltë

☐ 2

Normal

☐ 3

i shpejtë

☐ 4

shumë i shpejtë

☐ 5

15. Pa marrë parasysh tarifat e avokatit, si i vlerësoni kostot e aksesit e drejtësisë?

kosto shumë të
ulëta

☐ 1

kosto të ulëta

☐ 2

kosto mesatare

☐ 3

kosto të larta

☐ 4

kosto shumë të
larta

☐ 5

16. Bazuar në përvojën tuaj, si i vlerësoni burimet në dispozicion të gjykatës?

shumë të
pamjaftueshme

☐ 1

të
pamjaftueshme

☐ 2

të mjaftueshme

☐ 3

tepër të
mjaftueshme

☐ 4

17. Në përgjithësi, si e vlerësoni mundësinë e informimit për të drejtat tuaja?

shumë e vështirë

☐ 1

shumë e vështirë

☐ 2

mjaft e lehtë

☐ 3

shumë e lehtë

☐ 4

18. A keni përdorur mbrojtje ligjore?

☐ 1 po

☐ 2 jo

19. A ju është dhënë ndihmë juridike?

☐ 1 po

☐ 2 jo

20. A keni qenë në kontakt me një gjykatë tjetër të ndryshme nga gjykata në Lushnjë?

☐ 1 po, (specifikoni cili)

☐ 2 jo

21. A keni ndonjë vërejtje ose sugjerim për të bërë në lidhje me funksionimin e gjykatës në Lushnjë dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi?

.....

.....

Dëshironi të merrni pjesë në aktivitete të tjera si takime, aktivitete publike rreth kësaj çështje?

PO

JO

Nëse po, ju lutem lini një numër kontakti ose email mëposhtë:

ANEKS 2. INTERVISTAT

INTERVISTË ME KRYETAREN E GJYKATËS (E.C) SË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

- 1. Prej sa kohësh ushtroni pozicionin e Gjyqtares? Prej sa kohësh në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.**

Ushtroj funksionin e Gjyqtares që prej vitit 2007. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë që prej vitit 2009. Si Kryetare kam që në vitin 2014.

- 2. Cilat kanë qënë objektivat tua kryesore në përmirësimin e procesit të punës në këtë gjykatë pas marrjes së pozicionit të Kryetares së Gjykatës, dhe a ja keni arritur të realizoni pjesën më të madhe të tyre deri më tani?**

Vleresoj që një pjesë e mirë e objektivave, janë arritur. Shërbimi cilësor ndaj publikut, rritja e aftësisë profesionale të administratës gjyqësore, rritja e sigurisë në gjykatë, krijimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e gjykimeve, rritja e besimit të publikut tek dhënia e drejtësisë, marrja e masave për përfundimin e gjykimeve Brenda afateve të arsyeshme, duke bërë mbledhje të vazhdueshme me Gjyqtarët. Këto janë disa nga objektivat kryesore.

- 3. A paraqet vështirësi për ju mos ndarja e përhershme e gjyqtareve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, në sesione përkatëse, civile, penale? Nëse po cilat janë këto vështirësi?**

Po paraqet vështirësi të dukshme, pasi një Gjyqtari I duhet njëkohësisht të trajtojë çështje të natyrave të ndryshme.

- 4. A ka krijuar numri i reduktuar i gjyqtarëve të atashuar pranë kësaj gjykate ngarkesa dhe vonesa të mëdha në zhvillimin e proceseve ligjore? Nese po, sipas mendimit tuaj cilat janë pasojat më të mëdha të këtyre vonesave dhe si reflektohen ato në vijimësi.**

Po numri i reduktuar i gjyqtarëve ka krijuar vonesa dhe ngarkesa e madhe në punë ndikon në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore. Kjo passjell zvarritje të gjykimeve dhe ulje të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Këtë shqetësim e kemi përcjellë tek institucionet përkatëse por deri më tani nuk është marrë ndonjë masë.

- 5. A ndiheni të sigurtë gjatë dhënies së vendimeve (kryesisht penale), pasi mesa vihet re gjykata nuk është e pajisur me sistem të lartë sigurie, si dhe shpesh herë rezulton se për shkak të fluksit të çështjeve që trajtohen nga kjo gjykatë, disa procese penale trajtohen në salla të papajisura me kafaz apo mjete të tjera sigurie të lidhur me natyrën e këtyre çështjeve.**

Po ndjehemi të sigurtë. Nuk kam pasur asnjëherë ndonjë shqetësim në këtë aspekt.

- 6. A ka ndikuar ndonjëherë “presioni” i medias vizive dhe të shkruar në dhënien e vendimeve të “kënaqshme” për opinionin publik? A keni konstatuar gjatë një procesi që media të ketë influencuar në mënyrë e qëndrimit të gjyqtarit, prokurorit, avokatëve apo deshmitarëve në një seancë të caktuar gjyqësore. Nëse po, si është zgjidhur kjo situatë?**

Jo nuk ka ndikuar presioni I medias në dhënien e një vendimi, të paktën përsa më përket mua si Gjyqtare

- 7. Sa zgjat mesatarisht një proces gjyqësor në Gjykatën tuaj, nga fillimi i procesit deri në dhënien e vendimit?**

Një process gjyqësor përgjithësisht mbaron Brenda afateve të arsyeshme të përcaktuara në ligj. Megjithatë përgjithësisht një çështje themeli mund të zgjasë 3-4 muaj, kuptohet në varësi të natyrës së çështjes.

- 8. A keni një statistikë të çështjeve të rrëzuara në gjykatat me të larta për gjykatën tuaj?**

Po ka statistika të pjesshme, kur bëhet analiza vjetore e Gjyaktës.

- 9. Cilat janë vështirësitë konstante, të përditshme gjatë ushtrimit të profesionit tuaj. Çfarë mund të rregullohet dhe nga cila strukturë varen këto rregullime?**

Vështirësi ka lidhur me ngarkesën në punë dhe jemi në pritje të riorganizimit të sistemit gjyqësor.

- 10. Cilat janë pritshmëritë tuaja afatmesme dhe afatgjata në vijimin e punës pranë kësaj gjykate.**

Vlerësoj se objektivi kryesor është përfundimi i gjykimeve brenda afateve të arsyeshme dhe rritja e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

INTERVISTË ME GJYKATËS (Z.T) SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

- 1. Prej sa kohësh ushtroni pozicionin e Gjyqtares? Prej sa kohësh në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.**

Ushtroj funksionin e Gjyqtares që prej vitit 1998 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

- 2. A paraqet vështirësi të mos atashuarit në një sesion të caktuar, penal apo civil të gjyqëtarit? Nëse po cilat janë këto vështirësi?**

Po paraqet vështirësi, pasi një Gjyqtari i duhet njëkohësisht të trajtojë çështje të natyrave të ndryshme.

- 3. A ka krijuar numri i reduktuar i gjyqëtarëve të atashuar pranë kësaj gjykate ngarkesa dhe vonesa të mëdha në zhvillimin e proceseve ligjore? Nëse po, sipas mendimit tuaj cilat janë pasojat më të mëdha të këtyre vonesave dhe si reflektohen ato në vijimësi.**

Po numri i reduktuar i gjyqtarëve ka krijuar vonesa dhe ngarkesa e madhe në punë ndikon në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore. Kjo passjell zvarritje të gjykimeve dhe ulje të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Këtë shqetësim e kemi përcjellë tek institucionet përkatëse por deri më tani nuk është marrë ndonjë masë.

- 4. A ndiheni të sigurtë gjatë dhënies së vendimeve (kryesisht penale), pasi mesa vihet re gjykata nuk është e pajisur me sistem të lartë sigurie, si dhe shpesh herë rezulton se për shkak të fluksit të çështjeve që trajtohen nga kjo gjykatë, disa procese penale trajtohen në salla të papajisura me kafaz apo mjete të tjera sigurie të lidhur me natyrën e këtyre çështjeve.**

Po ndjehemi të sigurtë. Nuk kam pasur asnjëherë ndonjë shqetësim në këtë aspekt.

- 5. A trajnohen mjaftueshëm gjyqëtarët lidhur me çështje të cilat paraqesin risi si për nga ana legislative dhe ajo njerëzore?**

Po trajnohemi mjaftueshëm.

- 6. A ka ndikuar ndonjëherë “presioni” i medias vizive dhe të shkruar në dhënien e vendimeve të “kënaqshme” për opinionin publik? A keni konstatuar gjatë proceseve tuaja që media të ketë influencuar në mënyrë e qëndrimit të trupit gjykues, prokurorit, avokatëve apo deshmitarëve në një seancë të caktuar gjyqësore. Nëse po, si është zgjidhur kjo situatë?**

Jo nuk ka ndikuar presioni I medias në dhënien e një vendimi.

7. Sa zgjat mesatarisht një proces gjyqësor civil, nga fillimi i procesit deri në dhënien e vendimit? Cilat janë arsyt kryesore të zgjatjeve të afateve?

Një proces gjyqësor përgjithësisht mbaron Brenda afateve të arsyeshme të përcaktuara në ligj. Megjithatë përgjithësisht një çështje themeli mund të zgjasë 3-4 muaj, kuptohet në varësi të natyrës së çështjes.

8. A ju ndodh shpesh që çështje të cilat nisin si konflikte gjyqësore të përfundojnë me marrëveshje ndërmjet palëve? A mendoni se gjykata ka patur rol në këto zgjidhje, nëse po cili ka qënë roli i saj?

Shume rrallë, kryesisht në procese gjyqësore me objekt “Zgjidhje martese”. Roli i gjykatës i rendesishem.

9. Cilat janë vështirësitë konstante, të përditshme gjatë ushtrimit të profesionit tuaj. Çfarë mund të rregullohet dhe nga cila strukturë varen këto rregullime?

Vështirësi ka lidhur me ngarkesën në punë dhe jemi në pritje të riorganizimit të sistemit gjyqësor.

10. Cilat janë pritshmëritë tuaja afatmesme dhe afatgjata në vijimin e punës pranë kësaj gjykate.

Vlerësoj se objektivi kryesor është përfundimi I gjykimeve brenda afateve të arsyeshme dhe rritja e besimit të publikut tek sistemi I drejtësisë.

11. Mendoni se gjyqtarët shpërblehen në mënyrë të drejtë për punën që bëjnë?

Jo. Punojne efektivisht mbi 10 orë në ditë.

INTERVISTË ME KANCELARIN (E.S) E GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

1. Prej sa kohësh ushtroni pozicionin e Kancelarit në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Lushnje? A keni patur më parë eksperiencë të ngjashme në gjykata simotra?

Funksionin e Kancelarit ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje e ushtroj qe prej dates 30.04.2013. Nga viti 1998 deri Gusht 2006 Shef I Sektorit Juridik dhe Shef Personeli ne sistemin e burgjeve.

Gusht 2006 deri ne Prill 2013 jurist dhe Inspektor ne organet tatimore.

2. Cilat janë detyrat tuaja në pozicionin e Kancelarit të Gjykatës, a konfundohen ato me detyrat e Kryesekretares, pasi rregullorja e institucionit nuk bën një ndarje të qartë ndërmjet këtyre dy pozicioneve.

Detyrat e kancelarit dhe kryesekretares jane te percaktuara ne Ligjin per Pushtetin Gjyqësor. Duke qene se rregullorja e gjykates ka dale perpara hyrjes ne fuqi te ketij ligji, zbatohet per aq sa nuk bie ne kundërshtim me kete ligj.

3. Si llogaritet buxheti vjetor i gjykatës, cilat janë zërat konstant të buxhetit dhe a është i mjaftueshëm ai për mbarëvajtjen e punës deri në fund të vitit kalendarik?

Buxheti llogaritet (me perafersi) duke patur parasysh faktin e vitit paraardhes.

Te zerat konstant futen shpenzimet per posten, energjine elektrike, ujin e pijshem, tonera, shtypshkrime, abonime, avokatet kryesisht, ekspertet mjeko ligjore dhe shpenzime kancelarie. Ky buxhet ka qene i mjaftueshem pasi ndonjehere jane perdorur edhe te ardhurat e krijuara nga gjykata ose eshte kerkuar shtese fondi, i cili eshte miratuar nga ZABGJ

4. Në mendimin tuaj ka krijuar numri i reduktuar i gjyqtarëve të atashuar pranë kësaj gjykate ngarkesa dhe vonesa të mëdha në zhvillimin e proceseve ligjore? Nëse po, cilat janë pasojat më të mëdha të këtyre vonesave dhe si reflektohen ato në vijimësi.

Numri i reduktuar i gjyqtareve ka sjelle vonesa ne zhvillimin e proceve gjyqësore, pasi ka aktualisht ne detyre 4 gjyqtare, madje per disa kohe, per arsye shëndetsore (leje lindje) kane qene ne pune 2 gjyqtare. Aq me teper qe me ndryshimet e fundit te K.Pr. Penale dhe K.Pr. Civile ngarkesa jo vetem e gjyqtareve por edhe e punonjesve te gjykates eshte rritur. Ka lindur edhe shpesh nevoja per delegimin e gjyqtareve nga rrethe te tjera per plotesimin e trupave gjykues. Po ashtu eshte e nevojshme edhe shtimi i stafit administrativ te gjykates.

5. A dispononi ndonjë statistikë për numrin e seancave për secilin gjykim?

Mesatarisht numri i seancave per nje ceshtje civile eshte 3 seanca, kurse per ceshtjet penale eshte 2,2 seanca. Si shkak kryesor per shtyrjen e seancave jane kerkesat per shtyrje nga palet(avokatet).

6. Sa zgjat mesatarisht një proces gjyqësor civil, nga fillimi i procesit deri në dhënien e vendimit? Cilat janë arsyet kryesore të zgjatjeve të afateve? Po procesi penal?

Nuk kam një të dhënë të saktë për informacionin e kërkuar. Si shkak kryesor për shtyrjen e seancave janë kërkesat për shtyrje nga palet(avokatet).

7. Cilat janë vështirësitë konstante, të përditshme gjatë ushtrimit të profesionit tuaj. Çfarë mund të rregullohet dhe nga cila strukturë varen këto rregullime?

Duhet të jeni të ndara në mënyrë me të qartë detyrat funksionale të kryetarit të gjykates dhe të kancelarit, rregullime këto që duhet të kryhen nga struktura e KLGJ (kur të krijohet). Gjithashtu, KLGJ do të përcaktojë edhe funksione me të hollësishme për të gjithë punonjësit e gjykates

8. Cilat janë pritshmëritë tuaja afatmesme dhe afatgjata në vijimin e punës pranë kësaj gjykate.

Jam në pritje të përmirësimeve cilësore të sistemit gjyqësor në përgjithësi.

9. Mendoni se shpërbleheni në mënyrë të drejtë nga ana monetare për punën që bën?

Aktualisht, duke parë edhe pagat e gjyqtareve, mendoj se shpërblehemi mirë nga ana monetare, por në të ardhmen, sipas ligjit për Pushtetin Gjyqësor, nuk mendoj se do të shpërblehemi mjaftueshëm.

**INTERVISTË ME KOORDINATORIN (M.K) E GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
LUSHNJE**

- 1. Prej sa kohësh ushtroni pozicionin e Koordinatorit në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Lushnje? A keni patur më parë eksperiencë të ngjashme në gjykata simotra?**

Pozicionin e koordinatorit ne Gjykatën e Rr. Gjyqësor Lushnje e ushtroj prej 16.05.2016. Nuk kam patur më parë eksperiencë të ngjashme. Në pozicionin e punonjësës së IT prej Maj 2011.

- 2. Cilat janë detyrat tuaja në pozicionin e Koordinatorit të Gjykatës?**

Detyrat e Koordinatorit janë ato në përputhje me LIGJIN Nr. 119/2014 “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”

- a) I mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;
- b) Krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji;
- c) Bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj;
- ç) Regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;
- d) Dërgon kërkesën për informim tek një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;
- dh) Verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 13, të këtij ligji;
- e) Kryen njoftimet paraprake, sipas neneve 14 dhe 15, të këtij ligji, si dhe komunikon me kërkuar, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

- 3. Cilat janë mjetet e informimit që përdorni për të tretët në Gjykatën e Lushnjes. A janë ato efikase? A mendoni se duhet të përdorni mjete më të shpejta të njoftimit, si psh faksi?**

Mjetet e informimit kanë qënë në përgjithësi në rrugë elektronike (e_mail), ëëbi i gjykatës ëëëë.gjykata.gov.al/rrethi-lushnje në të cilën publikohen informacione si psh. Rregulloret, njoftime të ndryshme, afishime, etj.

Mendoj si mjete më të shpejta të njoftimit mund të jenë edhe nëpërmjet nr. cel nëse kërkuar bie dakort dhe të depozitoj nr. e tel.

- 4. Përmëndni një eksperiencë jo të mirë që keni patur gjatë ushtrimit të funksionit tuaj me palët e treta.**

Nuk kam patur ndonjë eksperiencë jo të mirë gjatë ushtrimit të funksionit si koordinator.

5. A mendoni që e drejta për t'u informuar zbatohet në mënyrë të drejtë nga instancat përkatëse të gjykatës. Nëse jo cilat janë përmirësimet që mund të bëhen në këtë aspekt?

Mendoj se zbatohet në mënyrë të drejtë nga instancat përkatëse.

6. A ju është kërkuar ndonjëherë nga eprorët tuaj të drejtëpërdrejtë apo të tjerë të mos jepni informacion për çështje të caktuara. Nëse po të çfarë natyre kanë qënë ato?

Nuk më është kërkuar asnjëherë mos dhënia e informacionit, ka patur raste kur janë kërkuar vendime të ndryshme dhe ne Në respekt të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe udhëzimit të Ministrit Nr. 4059/2 datë 07.06.2016 për "Anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave" neni 6 pika 4 ku thuhet: "Kopja fizike e vendimit gjyqësor të anonimizuar përfshihet në dosjen gjyqësore të çështjes përkatëse. Vetëm kopja e vendimit të anonimizuar i vihet në dispozicion personave të interesuar për përdorimin e vendimeve gjyqësore për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi"

7. Cilat janë vështirësitë konstante, të përditshme gjatë ushtrimit të profesionit tuaj. Çfarë mund të rregullohet dhe nga cila strukturë varen këto rregullime?

Unë jam punonjëse IT dhe vështirësia qëndron në faktin se duke mos pasur formim juridik duhet të jem tërë kohën në kontakt me kryetarin apo kancelarin për trajtimin e kërkesave të ndryshme sa i përket detyrës së koordinatorit. Sa i përket profesionit tim do të duhej të përcaktoheshin qartë detyrat e punonjësit të IT nga instancat përkatëse (struktura e KLGJ-se kur të krijohet)

8. Cilat janë pritshmëritë tuaja afatmesme dhe afatgjata në vijimin e punës pranë kësaj gjykate.

Të ulet ngarkesa e punës dhe të kete një përcaktim të qartë të detyrave.

9. Mendoni se shpërbleheni në mënyrë të drejtë nga ana monetare për punën që bën?

Duke parë sistemin e pagave ne pergjithesi mendoj se shperblehemi mire, por ngarkesa eshte shume e larte.

INTERVISTË ME SEKRETARE (L.D) TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

1. Prej sa kohësh ushtroni pozicionin e sekretarit në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Lushnje? A keni patur më parë eksperiencë të ngjashme në gjykata simotra?

Qe prej Dhjetori 2010. Nuk kam patur me pare eksperienca te ngjashme

2. Cilat janë detyrat tuaja në pozicionin e Kryesekretarit/ sekretarit të Gjykatës?

Sekretari i seancës, veç detyrave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale e Civile, si dhe atyre që u caktohen nga gjyqtarët përgjatë dhe për shkak të procesit, kryen edhe detyrat e percaktuara ne rregulloren e gjykates.

1. Marrjen në dorëzim të dosjeve/çështjeve që i kanë rënë për gjykim gjyqtarit me të cilin punon;
2. Kryen njoftimet e palëve ndërgjyqëse, sipas urdhërimit të gjyqtarit, si dhe, në ato raste kur seanca shtyhet jo për shkak të gjykatës, kujdeset për arkëtimin parapagim të shpenzimeve të njoftimit, në çështjet civile. Në këtë rast të fundit, kjo realizohet ose duke depozituar pala përgjegjëse pullat e shërbimit postar, ose nëpërmjet prerjes së mandat-pagesës së shpenzimit në zyrën e llogarisë.
3. Sekretarja e seancës, kur përgatit njoftimet, në çdo rast shënon në to edhe numrin e aktit dhe, nëse janë më shumë se një njoftim për tu kryer për një çështje, atëherë për çdo njoftim numri i aktit shoqërohet me një numër me fraksion, që i korespondon numrit të kopjeve sa janë njoftimet për t'u kryer. Njoftimet duhet të përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara, lidhur me palët, cilësinë e tyre, objektin e kërimit, datën dhe orën e seancës, si dhe një kopje të kërkesëpadisë, kur njoftohet seanca e parë;
4. Nëqoftëse ka raste përjashtimore, kur seanca e planifikuar, për shkaqe të ngutshme, është caktuar të zhvillohet në një kohë më të shpejtë se koha e nevojshme për të kryer njoftimin nga shërbimi postar, sipas të dhënave të komunikuar nga ky i fundit, atëherë sekretari/ja i/e seancës, me porosi të gjyqtarit, komunikon me kancelarin në mënyrë që ky njoftim të kryhet nga nëpunësi gjyqësor ose shërbimi i specializuar i kontraktuar për këtë qëllim. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për procese të caktuara, kur për arsye të bazuara gjyqtari vlerëson kryerjen e njoftimit në këtë mënyrë. Ky shërbim do të kryhet nga nëpunësi gjyqësor tej orarit që konsiderohet me fluksin më të madh të gjykimeve në gjykatë;
5. Në rastet kur nuk realizohet nga vetë gjyqtari, kryen sipas urdhërimit të këtij të fundit planifikimin e seancës gjyqësore në sistemin ICMIS. Në rastet kur gjykimi parashikohet të zhvillohet në sallën e gjykimit, paraprakisht, para se të bëhet planifikimi, i mundëson gjyqtarit shfrytëzimin e kalendarit elektronik(PAKS), në mënyrë që të evitohen mbivendosjet e mundshme me gjykimet e gjyqtarëve të tjerë në këto salla. Gjithashtu, meqenëse numri i sallave është më i vogël se ai i gjyqtarëve, për aq sa është e mundur, sallat e gjykimit do të shfrytëzohen nga gjyqtarët, duke respektuar radhën e preferimit për secilën prej tyre, sipas urdhrit të kryetarit për këtë gjë;
6. Mban procesverbalin e seancës gjyqësore, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Penale e Civile, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë me nr. 282,

datë 15/06/2012, "Për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio";

7. Kujdeset për dorëzimin, kundrejt nënshkrimit, të dosjeve të përfunduara dhe sistemuara sipas alteve ligjore e nënligjore në fushën e arkivave, si dhe në respektim të udhëzimit të gjyqtarit, që është përgjegjës për ndërtimin e një dosjeje lehtësisht të shfrytëzueshme;
8. Përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të procesit gjyqësor, si dhe nga seanca në seancë, punon në mënyrë sistematike dhe në kohë reale me veprimet në sistemin ICMIS, siç është, planifikimi i seancave, ora e fillimit dhe e mbylljes së seancës, duke shënuar edhe shkaku pse ajo ka filluar me vonesë deri tek hedhja e dispozitivit, vendimit të arsyetuar e mbyllja e çështjes në sistem, duke e dërguar tek kryesekretarja edhe në rrugë elektronike. Etj etj.

3. A keni vështirësi në mjetet e njoftimit të palëve gjatë një procesi gjyqësor? Nëse po cilat janë ato dhe si mund të përmirësohen? Mendoni që njoftimi vetëm i palës do ishte me efikas në këtë rast?

Kemi vështirësi për faktin se kërkesa padia dorëzohet jo me adrese të sakta sidomos për palën e paditur.

4. Përmendni një eksperiencë jo të mirë që keni patur gjatë ushtrimit të funksionit tuaj me palët e treta.

Nuk kam patur eksperiencë jo të mirë.

5. Cili është raporti juaj me gjyqtarin? A ju është kërkuar ndonjëherë të bëni dëkë që tejkalon kompetencat tuaja gjatë punës?

Nuk më është kërkuar asnjëherë një gjë e tillë.

6. A jeni gjithmonë të atashuar pranë një gjyqtari apo për shkak të numrit të vogël të administratës dhe volumit të çështjeve të Gjykatës nuk keni qënë përmanent tek një gjyqtar. Nëse po a ju ka konfunduar ndonjëherë kjo situatë? Cilat janë pasojat?

Nuk kemi qënë gjithmonë të atashuar pranë një gjyqtari, dhe për shkak të volumit të madh të punës punojmë me të gjithë gjyqtarët si dhe gjyqtarët e deleguar. Jo kjo situatë nuk na konfunduar.

7. Cilat janë vështirësitë konstante, të përditshme gjatë ushtrimit të profesionit tuaj. Çfarë mund të rregullohet dhe nga cila strukturë varen këto rregullime?

Për shkak të ngarkesës të jashtëzakonshme të punës dhe mungesës së organikes detyrohemi të dalim në punë edhe jashtë orareve zyrtare dhe në ditët e pushimeve zyrtare.

Kjo mund të rregullohet nga strukturat perkatese në shtimin e organikes se të gjykatesve dhe administrates.

8. Cilat janë pritshmëritë tuaja afatmesme dhe afatgjata në vijimin e punës pranë kësaj gjykate.

Priteshmerita jane qe te rritet organika dhe te ulet volumi i punes

9. Mendoni se shpërbleheni në mënyrë të drejtë nga ana monetare për punën që bën?

Nuk mendoj se shperblehemi per punen qe kryejme ne perputhje me ngarkesen e tejskajshme qe eshte ne kete gjykate, gjithashtu nuk paguhemi kur dalim ne pune ne ditet e pushimeve.

INTERVISTË ME KRYE/SEKRETARE (A.B) TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
LUSHNJE

- 1. Prej sa kohësh ushtroni pozicionin e Kryesekretarit/ sekretarit në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Lushnje? A keni patur më parë eksperiencë të ngjashme në gjykata simotra?**

Pozicionin e Kryesekretarit e kam filluar prej periudhes 2006-2012, 2015 e ne vazhdim. Periudha tjeter ka qene sekretare séance gjyqesore. Nuk kam patur eksperienca ne gjykata te tjera.

- 2. Cilat janë detyrat tuaja në pozicionin e Kryesekretarit/ sekretarit të Gjykatës?**

Përveç detyrave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale e Civile, kryen edhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e gjykatës. Kryesekretari është përgjegjës direkt për organizimin e brendshëm të punës në kryesekretari, sipas detyrave të përcaktuara nga kjo rregullore.

2. Kryesekretari në rast përcaktimi në organikë kryen këto detyra:
- i. Pranon depozitimin e kërkesave civile, kërkesë-padive dhe çështjeve penale të ardhura nga prokuroria. Në rastin e çështjeve civile, kryesekretarja, si një filtër paraprak, pavarësisht statusit juridik si të “meta padie”, si dhe verifikon që kërkesa apo kërkesë-padia, së bashku me aktet provuese, janë paraqitur në atë kopje sa ç’janë palët ndërgjyqëse. Gjithashtu, me kërkesë të palës së interesuar, lëshon vërtetimin përkatës për këtë qëllim;
 - ii. Kontrollon dhe dokumenton procesin e dorëzimit të dosjeve të përfunduara me vendim të arsyetuar, penale e civile,
 - iii. Përgjigjet për dërgimin e kopjeve të vendimeve penale prokurorisë. Sa i takon komunikimit të vendimeve për palët në mungesë, kryesekretarja bën dërgimin e tyre së bashku me dëftesat e komunikimit. Gjithashtu kryesekretarja pranon depozitimin e ankimeve ndaj vendimeve gjyqësore penale a civile, duke bërë njëkohësisht protokollimin e tyre për çdo ditë, të cilin ia paraqet për nënshkrim kryetarit.
 - iv. Në eventualitetin që ankimi është bërë ndaj një vendimi që nuk lejohet ankim, nga një person që nuk legjitimohet, në tejkallim të afatit të ankimit të parashikuar në ligj etj, në kuptim të nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe kur nuk plotëson kushtet e parashikuara në nenet 453, 454 e 455 të Kodit të Procedurës Civile, kur ky fakt është i dukshëm e flagrant, ankimi nuk kthehet administrativisht, por me këtë rast mbahet një procesverbal, nëpërmjet të cilit konstatohet fakti që ka krijuar tashmë një çështje civile, e cila ndahet për gjykim me short;
 - v. Komunikon ankimet dhe apelet kundërshtuese, si dhe përgatit dhe dërgon dosjet në gjykatat më të larta në rastet kur ka ankim apo rekurs;

- vi. Lëshon kopje të vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera të njësuar me origjinalin vetëm për personat që provojnë interesin e ligjshëm në këtë drejtim, pasi kanë bërë paraprakisht kërkesë, të shoqëruar me parapagimin e shërbimit;
- vii. U dërgon kopje të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, sipas rastit, zyrës së gjendjes civile, zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme etj. Në këtë rast të fundit, duke mbajtur në konsideratë edhe disponimin e gjyqtarit, rast pas rasti, merr masa për të përmbushur detyrimet që burojnë nga neni 196 e 197 i Kodit Civil;
- viii. Koncepton vërtetimet nëse një person fizik apo juridik gjendet në një proces gjyqësor penal a civil pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, të cilat i lëshon, sipas rastit, më nënshkrimin e kryetarit apo kancelarit;
- ix. Jap formë të prerë vendimeve, me qëllim krijimin e volumeve penale, civile, të masave të sigurimit etj;
- x. Merr masa për arkivimin e dosjeve gjyqësore në rastet kur vendimi ka marrë formë të prerë;
- xi. Kryen regjistrimin në sistemin ICMIS të të gjitha çështjeve, sipas natyrës së sigluar nga kryetari për secilën prej tyre. Paraprakisht ajo verifikon në sistem nëse për ndonjë nga çështjet është vendosur më parë pushimi i gjykimit, në mënyrë që nëpërmjet komandës “rihapje”, prej vetë asaj ose komandës “short manual”, të ushtruar prej kryetarit, çështja t’i kalojë për gjykim përsëri gjyqtarit që e ka pushuar;
- xii. Regjistron manualisht në regjistrat fizikë të gjykatës çështjet e depozituara në gjykatë. Pas regjistrimit elektronik në sistemin ICMIS dhe shortimit, pasqyron këtë fakt në indekset përkatëse, krijon fashikujt, sipas natyrës së çështjeve dhe ia shpërndan ato sekretareve, sipas gjyqtarëve që u kanë rënë për gjykim;
- xiii. Përgjigjet për pranimin e kërkesave të prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake, duke i regjistruar ato në regjistrin përkatës të masave dhe duke ia shpërndarë ato gjyqtarit të fazës së hetimeve paraprake, sipas rastit. Në rastin e kërkesave me karakter sekret, siç janë ato që kanë të bëjnë me masën e arrestit në burg, në mungesë, kontrollin apo përgjimin, kujdeset që t’i regjistrojë ato pa bërë publik identitetin e subjektit, nëpërmjet mosçenimit të zarfit të mbyllur që mund të depozitohet në sekretari nga prokuroria, apo drejtpërdrejt tek gjyqtari;
- xiv. Numërtton dosjet/vendimet e shpallura çdo ditë, duke realizuar njëkohësisht edhe pasqyrimin e kësaj në indekset përkatëse;
- xv. Kudeset për administrimin, sistemin dhe arkivimin e fashikujve me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi”;
- xvi. Kryeson procesin e mbartjes së dosjeve në fund të çdo viti;
Se fundmi me ndryshimet e K.Pr. Penale regjistrohen në rregj. Perkates dhe në Sistemin ICMIS-CCMIS të gjitha kërkesat e paraqitura nga Prokuroria.

3. A keni vështirësi në mjetet e njoftimit të palëve gjatë një procesi gjyqësor? Nëse po cilat janë ato dhe si mund të përmirësohen? Mendoni që njoftimi vetëm i palës do ishte me efikas në këtë rast?

Veshtiresi ne percaktimin e adresave te sakta. Mendoj qe ne çeshtje Kthim aktesh te njoftohet vetem pala paditese dhe jo palet e tjera, pasi eshte vendim jo perfundimtar.

4. Përmëndni një eksperiencë jo të mirë që keni patur gjatë ushtrimit të funksionit tuaj me palët e treta.

Nuk kam patur.

5. Cili është raporti juaj me gjyqtarin? A ju është kërkuar ndonjëherë të bëni dicka që tejkalon kompetencat tuaja gjatë punës?

Nuk me eshte kerkuar asnjehere dicka qe tejkalon kompetencat.

6. A jeni gjithmonë të atashuar pranë një gjyqtari apo për shkak të numrit të vogël të administratës dhe volumit të çështjeve të Gjykatës nuk keni qënë përmanent tek një gjyqtar. Nëse po a ju ka konfunduar ndonjëherë kjo situatë? Cilat janë pasojat?

Ka patur raste për shkak të numrit të reduktuar të sekretareve. Por unë për shkak të pozicionit dhe ngarkesës që kam jam atashuar vetëm pranë kryetares së gjykatës.

7. Cilat janë vështirësitë konstante, të përditshme gjatë ushtrimit të profesionit tuaj. Çfarë mund të rregullohet dhe nga cila strukturë varen këto rregullime?

Me ndryshimet e fundit te K.Pr. penale eshte shtuar volume i punes ne maksimumin e mundshem. Puna nuk ka ora zyrtar çdo dite punoj deri ne oren 18:00 dhe gjithashtu punoj dhe ne fundjave. Jam e gatshme çdo fundjave per rregjistrimin e masave te sigurimi dhe e gjithë puna e kryer jashte orarit 8-16:00 eshte e papaguar.

8. Cilat janë pritshmëritë tuaja afatmesme dhe afatgjata në vijimin e punës pranë kësaj gjykate.

Te ulet ngarkesa e punes duke shtuar ne organike nje sekretare rregjistruese pasi ne keto kushte eshte e veshtire kryerja e detyrave Brenda orarit zyrtar. Te percaktohen detyrat qarte pasi ne kryesekretari ka ngarkese shume te madhe pune qe ndjehesh e stresuar çdo dite.

9. Mendoni se shpërbleheni në mënyrë të drejtë nga ana monetare për punën që bën?

Nuk shperblehemi ne menyre te drejte krahasuar me volumen e madh te punes.

INTERVISTË ME AVOKATË (M.SH) PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

1. Prej sa kohësh ushtroni profesionin e avokatit dhe me çfarë çështjesh merreni kryesisht? Keni patur çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë?

Profesionin e Avokatit e ushtroj prej vitit 2010. Në këto vite pune dhe eksperience në këtë fushë kam trajtuar çështje të natyrave të ndryshme juridike, nëpër gjykata të rretheve të ndryshme të vëndit. Vitet e fundit jam fokusuar në çështje të fushës penale.

Sigurisht duke qënë se avokatia është një profesion i lirë, më është dhënë mundësia që të kem patur disa çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, pavarësisht se jam anëtarë i Dhomës së Avokatëve, Tiranë.

2. Cilat janë vështirësitë që hasni gjatë një procesi gjyqësor në këtë gjykatë?

Vështirësitë që hasen gjatë një procesi gjyqësorë janë të shumta, sidomos në disa gjykata të rretheve, të cilat kanë vështirësi për të gjetur rrugët e komunikimit sa më efikase me palët (avokatët të cilët nuk i përkasin atij rrethi), kjo për shkak dhe të infrastrukturës së dobët dhe të prapambetur që kanë këto institucione në këtë drejtim. Kjo situatë shpesh herë sjell vonesa, shtyrje të seancave gjyqësore dhe për rrjedhojë zvarritje të të gjithë procesit, duke lënë kështu një konflikt të hapur dhe të zgjatur në kohë.

3. Sa zgjat kryesisht një çështje gjyqësore pranë kësaj gjykate?

Eksperienca ime në këtë gjykatë ndër vite ka qënë e ndryshme. Duke qënë se proceset e natyrës penale kanë afate prekluzive mund të themi që respektimi i afateve ka qënë më i madh në këtë aspekt. Por dua të theksoj që kjo situatë nuk varet vetëm nga gjyqtari përkatës por dhe nga ngarkesa dhe kapacitetet që ka patur kjo gjykatë ndër vite. Si shembull po marr dy vitet e fundit në këtë gjykatë, ku organigrama e saj parashikon 5 gjyqtarë në përbërje të gjykatës, ndër të cilët vetëm 4 prej tyre kanë qënë të emëruar, ku një prej tyre ka qënë një vit me leje lindje. Mund të përfytyroni ngarkesën dhe pamundësinë e gjyqtarëve funksional për të respektuar afatet kohore të një procesi normal gjyqësor.

4. Cilat janë shkaqet e vonesave të seancave gjyqësore. A mendoni se mund të evitohen këto vonesa në shumicën e rasteve?

Sic përmënda dhe më sipër mendoj që shkaqet kryesore të vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore janë, numri i vogël i gjyqtarëve të parashikuar në organigramë për këtë gjykatë, mos plotësimi me gjyqtarë i organigramës së parashikuar (nga pesë gjyqtarë kjo gjykatë momentalisht prej disa vitesh funksionon me katër gjyqtarë). Mendoj parashikimi i një numri optimal gjyqtarësh të atashuar në këtë gjykatë do të sillte evitimin e vonesave apo shtyrjeve të seancave gjyqësore në shumicën e rasteve.

5. Cilat janë pasojat që sjellin për palët dhe vetë procesin këto vonesa?

Pasojat janë të shumta. Një nga shprehjet e para që më vjen ndërmendje është “Drejtësi e vonuar drejtësi e munguar”, cka do të thotë që cdo vonesë e pajustificueshme në zgjidhjen e një konflikti apo mosmarrëveshjeje pasjell për palët dhe jo vetëm mos vendosjen e së

drejtës së pretenduar, duke zgjeruar kështu në shumë raste vetë konfliktin apo kostot monetare që i ngarkohen palëve, gjë që sjell acarimin e tyre të mëtëjshëm.

6. Cilat janë mjetet e njoftimit që përdorë kjo gjykatë për të njoftuar palët? A mendoni se janë efikase? Keni hasur ndonjëherë vështirësi me to?

Dy janë mjetet e njoftimit që përdorë kryesisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, posta zyrtare (shkresore) dhe lajmërimi me telefon (në mendimin tim një mjet njoftimi informal). Shpesh herë këto mjete njoftimi nuk janë efikase për vetë rrjedhën e ngjarjes apo natyrën e çështjes. Një njoftim elektronik në kohë reale në faqën e ëbsitet të gjykatës do ishte më eficient dhe lehtësisht i aksesueshëm nga cdo palë e interesuar. Sic mund të mendohet vështirësi ka patur në marrjen e postës apo dhe mbritjen e një telefonate që shpesh here edhe mund ta neglizhosh për shkak të impenjimeve ditore.

7. Sa është kryesisht distanca kohore nga njëra seancë në tjetrën? A penalizon kjo distancë palët gjatë një procesi gjyqësor. Nëse po si?

Rastet janë të ndryshme nga njëri tjetri, gjithashtu dhe metoda e punës së gjyqtarëve ndryshon nga njëri gjyqtarë nga tjetri. Por sic përmënda dhe më lartë duke qënë se kohët e fundit jam marr me çështje kryesisht penale, afatet i ka përcaktuar ligji dhe në këtë rast është më e lehtë për të gjithë ne.

8. Gjatë eksperiencës tuaj pranë kësaj gjykate a rezultojnë më shumë seanca efektive se ato jo efektive gjatë një procesi gjyqësor? Cilat janë shkaqet kryesore të seancave jo efektive dhe si ndikojnë ato në zhvillimin e një procesi normal gjyqësor?

Sigurisht që gjatë një procesi gjyqësor ka raste kur hasemi edhe me seanca joefektive, në rastin tonë kur jemi në mungesë për shkaqe me arsye të prokurorit, avokatit mbrojtës apo ndonjëherë dhe të vet gjyqtarit. Por dua të theksoj që në rastet e trajtuara prej meje ka patur më shumë seanca efektive sesa joefektive.

9. Si është raporti avokatë -klientë? A i mirëkuptojnë klientët vështirësitë që hasni gjatë një procesi për shkak të burokracisë apo procedurave ndonjëherë të zgjata në gjykatë? Si i zgjidhni këto situata?

Zakonisht raporti avokatë klientë është një raport i ngritur mbi një marrëdhënie besimi. Element ky i domosdoshëm për të ngritur një strukturë solide në funksion të mbrojtjes më të mirë të së drejtës së pretenduar. Parë në këtë këndvështrim klientët në emërimin e përfaqësuesit të tyre (avokatit) janë të predispozuar të ndjekin me përpikmëri këshillat dhe rekomandimet e avokatit si dhe të bëjnë cdo shpjegim që i jep ai në lidhje me një rrethanë të caktuar, duke përfshirë këtu dhe procedurat burokratike apo zgjatjet e herëpashershme të procesit gjyqësor. Sigurisht që ndodh ndonjëherë që dhe vetë avokati të gjendet në situata jo kredible për shkak të vonesave apo burokracive të vet sistemit, jo për faj të tij. Mbetet detyrë e tij të bind dhe të arsyetoj këtë situatë përpara klientit të tij. Rrugë kjo që jo gjithmonë rezulton e suksesshme. Në këtë rast vetë klienti mund të zgjedh të ndryshoj përfaqësuesin e tij, gjë që për mendimin tim do të pas sillte vonesa edhe më të mëdha.

10. Në mendimin tuaj cilat janë mangësit kryesore në funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje? Si mund të përmirësohen ato? Jepni sygjerimet tuaja.

Mendoj që janë disa ceshtje kryesore të cilat do të kërkonin rishikimin apo plotësimin e nevojave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Mangesia e parë që më shkon në mendje është numri i vogël i gjyqtarëve të parashikuar në organigramën e kësaj gjykate, ose të paktën plotësimi i këtij numri me gjyqtarë funksional. Shtimi i stafit administrative. Përmirësimi i procedurave të njoftimeve, duke i kthyer ato përfundimisht në njoftime digitale lehtësisht të aksesueshme nga palët e interesuara.

INTERVISTË ME AVOKATË (F.M) PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

1. Prej sa kohësh ushtroni profesionin e avokatit dhe me çfarë çështjesh merreni kryesisht? Keni patur çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje?

Profesionin e avokatit e ushtroj që prej vitit 2014, kryesisht në fushën civile, ku kam trajtuar më shumë rastet e sigurimeve nga aksidentet. Duke qënë se rastet e aksidenteve kanë shtrirje territoriale të gjërë, më ka rastisur shpesh herë të kem procese gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje.

2. Cilat janë vështirësitë që hasni gjatë një procesi gjyqësor në këtë gjykatë?

Vështirësitë janë të shumta, që nga marrëdhënia me palët, me kompanitë e sigurimit, palët e treta etj. Do të vecoja në këtë rast disa vështirësi që kanë të bëjnë vecanërisht me procesin gjyqësor në këtë gjykatë si psh: mënyra e njoftimit të palëve lë shumë për të dëshiruar. Njoftimet bëhen nga sekretaria gjyqësore me poshtë elektronike apo telefon personal. Nëse rastisë që për një arsye apo tjetrën nuk kryen pagesën e pullës së postës (pas mbarimit të seancës gjyqësore, me lekë kesh tek sekretarja gjyqësore brenda sallës së gjyqit) rrezikon që ai njoftim most ë nisët kurrë duke bërë kështu një zvarritje artificiale të procesit gjyqësor. Vështirësi tjetër është mungesa e plotësimit të organigramës me gjyqtarë, gjë e cila con në një numër më të vogël gjyqtarësh e si rrjedhojë një kapacitet më i ulët për trajtimin e çështjeve gjyqësore, duke marrë këtu parasysh edhe rastet e mungesave të gjyqtarëve për shkaqe personale apo trajnimi.

3. Sa zgjat kryesisht një çështje gjyqësore pranë kësaj gjykate?

Kam patur eksperiencë të ndryshme në këtë gjykatë. Ndoshta dhe nga më ekstremet, kam patur çështje që kanë përfunduar në më pak se tre muaj si dhe çështje të cilat janë zgjatur deri në dy vjet, për shkaqe të zvarritjes së procesit gjyqësor. Gjë që më ka vënë në vështirësi të madhe me palët të cilët për shkak të natyrës së konfliktit kanë patur nevojë imediate për të përfunduar sa më parë procesin gjyqësor.

4. Cilat janë shkaqet e vonesave të seancave gjyqësore. A mendoni se mund të evitohen këto vonesa në shumicën e rasteve?

Sic përmenda dhe më sipër në mendim tim shkak kryesor është kapaciteti i ulët i organigramës së gjykatës për sa i përket numrit të gjyqtarëve. Duke qënë pak gjyqtarë ndodh që njëri syresh të ketë në ditë rreth 15-18 gjyqe të cilat afërmëndsh krijojnë një ngarkesë jo normale për gjyqtarin i cili në fund të fundit është i detyruar që përveçse të vendos drejtësi të respektoj dhe afatet ligjore. Rritja e numrit të gjyqtarëve të atashuar pranë kësaj gjykate mendoj se do ishte zgjidhje optimale për uljen e ngarkesës dhe evitim të vonesave të pajustificuara në proceset gjyqësore.

5. Cilat janë pasojat që sjellin për palët dhe vetë procesin këto vonesa?

Rastet të cilat unë trajtoj janë raste specifike, ku pala ka nevojë të menjëhershme për tu kompesuar në dëmin material dhe jo vetëm, i shkaktuar nga vërtetimi i faktit të paligjshëm. Rastet e aksidenteve kanë natyrë specifike juridike, sepse përvec shkaktimit të konfliktit kërkohet dhe dëmshpërblim i menjëhershëm për të rikuperuar pasojat kryesisht shëndetsore të palës së dëmtuar e cila në shumicën e rasteve gjëndet e papërgatitur për të mbuluar këto shpenzime. Vonesat në të tilla procese, jo vetëm vonojnë zgjidhjen e konfliktit por shpesh herë ndikojnë në cilësinë e jetës dhe shëndetit të palës së dëmtuar.

6. Cilat janë mjetet e njoftimit që përdorë kjo gjykatë për të njoftuar palët? A mendoni se janë efikase? Keni hasur ndonjëherë vështirësi me to?

Mendoj se një nga anët më negative të funksionimit të kësaj gjykate janë mjetet e njoftimit. Njoftimet atashohen kryesisht në faqet e murit të derës kryesore të gjykatës, lënë kështu në “mëshirë” të kushteve atmosferike apo sjelljeve personale të individëve. Gjykata nuk ka një sistem online ku palët e interesuara mund të aksesojnë lirshëm për të marr njoftime të ndryshme. Njoftimi me poste shkresore dhe telefonata personale për mua mbetet një rrugë primitive e njoftimeve të gjykatës, të cilat shpesh herë kërkojnë një kohë të caktuar dhe të gjatë për të vënë palët në lëvizje.

7. Sa është kryesisht distanca kohore nga njëra seancë në tjetrën? A penalizon kjo distancë palët gjatë një procesi gjyqësor. Nëse po si?

Kohët e fundit kam patur ekperiencia jo të mira me distancat kohore që gjyqtarët kanë lënë nga njëra seancë në tjetrën. Këto distanca variojnë nga 1.5 muaj në 3-4 muaj nga njëra seancë në tjetren. Gje që për mua rezulton absurde nëse të gjithë aktorët e një procesi gjyqësorë tentojnë të vendosin te drejtën e shkelur në vënd dhe të zgjidhin konfliktin ndërmjet palëve.

8. Gjatë eksperiencës tuaj pranë kësaj gjykate a rezultojnë më shumë seanca efektive se ato jo efektive gjatë një procesi gjyqësor? Cilat janë shkaqet kryesore të seancave jo efektive dhe si ndikojnë ato në zhvillimin e një procesi normal gjyqësor?

Do të isha i pavërtetë nëse do të thoja që shumica e seancave të zhvilluara, kryesisht në çështjet që unë trajtoj janë efektive. Shpesh ndodhemi në situatë ku seancat gjyqësore shtyhen për shkak të mosnjoftimit të palëve, ose mos arritjes në kohë të njoftimit, neglizhencës së ekspertëve, kërkesave për shtyrje (që në mendimin tim shpesh janë të pabazuara në ligj, por që gjytari për shkak të ngarkesës maksimale që ka i sheh si një dritë jeshile për “pak pushim”), apo mungesave të vet gjyqtarëve për shkaqe personale apo trajnimesh. Të gjitha këto seanca jo efektive ndikojnë në mbarëvajtjen e një procesi gjyqësor të rregullt e të qetë duke sjell kështu acarime ndërmjet vetë palëve pjesmarrëse si dhe të vet konfliktit.

9. Si është raporti avokatë -klientë? A i mirëkuptojnë klientët vështirësitë që hasni gjatë një procesi për shkak të burokracisë apo procedurave ndonjëherë të zgjatura në gjykatë? Si i zgjidhni këto situata?

Klientët përpiqen ti besojnë përfaqësuesit të tyre. Por shpesh herë absurditeti i zvarritjeve të procesit gjyqësor, vë dhe vet përfaqësuesin në vështirësi për ti dhënë shpjegime objektive klientit të tyre. Gjë që në disa raste krijon acarim apo krisje ndërmjet tyre. Por besoj që marzhi i tolerancës nga të dyja anët është më i lartë se e zakonshmja duke njohur të gjithë realitetin që na rrethon.

10. Në mendimin tuaj cilat janë mangësit kryesore në funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje? Si mund të përmirësohen ato? Jepni sygjerimet tuaja.

Shkurtimisht po rendis të gjitha pikat që I kam përmëndur dhe pak më lartë:

- Organigrama me numër të vogël gjyqtarësh;
- Mosplotësimi i organigramës me gjyqtarë, nga 5 të parashikuar në organigram ka vetëm 4 të emëruar në këtë gjykatë;
- Mospasja e një sistemi online njoftmesh;
- Zvarritja në periudha të gjata kohore të senacave gjyqësore nga njëra tjetra.

INTERVISTË ME AVOKATË (B.M) PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

1. Prej sa kohësh ushtroni profesionin e avokatit dhe me çfarë çështjesh merreni kryesisht? Keni patur çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje?

Kam rreth 5 vite që ushtroj këtë profesion dhe që kam hapur zyrën time të avokatisë. Zyra trajton raste nga më të ndryshmet, por unë personalisht jam e fokusuar tek rastet familjare që kanë të bëjnë me zgjidhjen e martesës, ndarjen e pasurisë martesore apo çështje që lidhen me kujdestarinë e fëmijëve. Gjatë këtyre 5 vitev kam patur vetëm dy çështje familjare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

2. Cilat janë vështirësitë që hasni gjatë një procesi gjyqësor në këtë gjykatë?

Të them të drejtën nuk kam hasur vështirësi madhore gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore që unë kam ndjekur. Besoj problematikat që kam hasur nuk kanë të bëjnë vetëm me këtë gjykatë por kanë më shumë lidhje me mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të sistemit gjyqësor në shqipëri. Këtu mund të përmend, vonesat në dërgimin e njoftimeve (njoftimet dërgohen ende me postë shkresore), shtyrjet e seancave gjyqësore për shkak të mosnjoftimit në kohë apo me vonesë të palëve, zvarritje të procesit për shkak të neglizhencës së ekspertëve apo mosparaqitjes së tyre në seanca gjyqësore për shkak të përplasjes së orareve etj. Por thënë kjo nga eksperiencia ime e deritanishme kjo situatë është e njëjtë në të gjitha gjykatat e rrethheve në vënd.

3. Sa zgjat kryesisht një çështje gjyqësore pranë kësaj gjykate?

Të them të drejtën unë kam patur fat në këtë gjykatë, çështjet që kam përfaqësuar nuk kanë zgjatur më shumë se 4-5 muaj. Kohë relativisht e shkurtër për një process civil, por vlen të theksoj që dhe natyra e çështjeve që unë trajtoj (familjare) është e tillë që kërkon zgjidhje të menjëhershme të konfliktit ndërmjet palëve.

4. Cilat janë shkaqet e vonesave të seancave gjyqësore. A mendoni se mund të evitohen këto vonesa në shumicën e rasteve?

Mendoj që në asnjë proces gjyqësorë nuk duhet të ketë vonesa dhe nëse ka ato lehtësisht mund të evitohen nëse merren masa paraprake. Më konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje duhet të merren masa sa më parë për digitalizimin e njoftimeve për palët e interesuara. S'mund të kënaqemi në vitin 2018 me njoftime të cilat ende dërgohen me postë të shkruar apo mesazhe nga ana sekretarisë së gjykatës në telefona personal. Për mendimin tim kjo mënyrë e dërgimit të njoftimeve sjell shpesh herë vonesa, konfondime dhe zvarritje të kota të procesit gjyqësor. Një mangësi tjetër që kam vënë re në këtë gjykatë është numri i pakët i gjyqtarëve, të cilët janë të mbingarkuar me çështje gjë që con në tejzgjatjen e panevojshme të proceseve.

5. Cilat janë pasojat që sjellin për palët dhe vetë procesin këto vonesa?

Palët i drejtohen gjykatës kur ndërmjet tyre ka lindur një konflikt/ mosmarrëveshje. Sigurisht që kjo është një situatë e tensionuar ndërmjet palëve, ku zgjidhja në kohë e konfliktit do ndihmonte jo vetëm palët, por shoqërinë dhe vetë shtetin njëkohësisht. Një tejzgjatje në kohë e procesit sjell gjithmone gjenerimin e konflikteve të tjera apo dhe vet zgjerimin e konfliktit.

6. Cilat janë mjetet e njoftimit që përdorë kjo gjykatë për të njoftuar palët? A mendoni se janë efikase? Keni hasur ndonjëherë vështirësi me to?

Mendoj që mjetet e njoftimit që përdorë kjo gjykatë, dhe jo vetëm kjo, është thembra e Akilit për systemin tonë gjyqësor. Jetojmë në një kohë ku cdo gjë lëvizë shumë shpejt përvec njoftimeve të bëra nga gjykatat tona. Njoftimi me postë të shkruar na kthen mbrapa në kohë dhe ngadalëson ritmin e jetës aktuale. Vështirësitë janë nga më të ndryshmet, si psh mos marrja në kohë reale të njoftimit është një penaltet që na kushton, kohe dhe shpenzime ne si palë përfaqësuese por dhe vetë palëve të interesuara. Shpesh herë na ndodh të lëvizim nëpër rrethe për çështje të ndryshme gjyqësore, njoftimi mbërin në adresën e punës, ti nuk je aty, postieri bën dorëzimin e postës pavarësisht mosqënies tënde, pala nuk merr njoftimin në kohë, të gjitha këto cojnë në vonesa të panevojshme e tejzgjatje të proceseve gjyqësore.

7. Sa është kryesisht distanca kohore nga njëra seancë në tjetrën? A penalizon kjo distancë palët gjatë një procesi gjyqësor. Nëse po si?

Sic përmënda dhe më sipër kam patur fatin që në këtë gjykatë proceset të më kenë ecur normalisht, distanca kohore nga njëra seancë në tjetrën nuk i ka kaluar asnjëherë më shumë se 15-20 ditë. Por për fat të keq ky shank nuk më ka ecur në të gjitha gjykatat, ku distanca kohore ndërmjet seancave varet shumë nga numri i gjyqtarëve të atashuar pranë gjykatës dhe ngarkesa që ato kanë.

8. Gjatë eksperiencës tuaj pranë kësaj gjykate a rezultojnë më shumë seanca efektive se ato jo efektive gjatë një procesi gjyqësor? Cilat janë shkaqet kryesore të seancave jo efektive dhe si ndikojnë ato në zhvillimin e një procesi normal gjyqësor?

Pothuajse 90% të seancave që unë kam ndjekur kanë qënë seanca efektive. Senacat jo efektive kanë patur kryesisht si shkak shtyrjen e seancave për shkak të mungesës së gjyqtarit të çështjes për shkakë të ndryshme, personale apo pune.

9. Si është raporti avokatë -klientë? A i mirëkuptojnë klientët vështirësitë që hasni gjatë një procesi për shkak të burokracisë apo procedurave ndonjëherë të zgjata në gjykatë? Si i zgjidhni këto situata?

Kryesisht klientët janë të paduruar për të zgjidhur konfliktin që ato kanë me palën tjetër. Për këtë arsye shpesh bëhen mosbesues dhe nganjëherë dhe vet pengesë për mbarëvajtjen

e cështjes. Është detyra jonë si përfaqësues dhe njohës të mirë të sistemit ti shpjegojmë me durim çdo fazë dhe etapë që ndjek një proces gjyqësor në shqipëri.

10.Në mendimin tuaj cilat janë mangësit kryesore në funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje? Si mund të përmirësohen ato? Jepni sygjërimet tuaja.

Unë mendoj që problemin kryesor Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje e ka me numrin e pakët të gjyqëtarëve të atashuar pranë kësaj gjykate. Duke qënë një rreth i mbipopulluar dhe me një shpeshtësi konfliktesh mbi normën e zakonshme, ngarkesa vjetore që kanë këto gjyqtarë është e madhe dhe shpesh herë e papërballueshme nga ana njerzore dhe profesionale. Mendoj që rritja e numrit të gjyqtarëve të emëruar pranë kësaj gjykate do të normalizonte sadopak situatën kaotike që është shkaktuar sidomos vitet e fundit në këtë gjykatë.